

Raporti Vjetor

Të drejtat e rezervuara për Agjencinë Kosovare të Pronës, (AKP), 2015.

Materialet e këtij publikimi mund të ripërdoren me kusht që të përmendet burimi kryesor i tyre.

Agjencia Kosovare e Pronës

Perandori Justinian 5

Prishtinë

Telefoni: +381 38 249 918

Telefax: +381 38 249 919

E-mail: mailbox@kpaonline.org

<http://www.kpaonline.org>



KOSOVO PROPERTY AGENCY
AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS · KOSOVSKA AGENCIJA ZA IMOVINU

Perandori Justinian 5 - Prishtinë/Pristina
Tel +381 (0)38 249 918 · Fax +381 (0)38 249 919
www.kpaonline.org · mailbox@kpaonline.org

NË MBROJTJE TË PRONËS PRIVATE – PROTECTING PRIVATE PROPERTY – ZAŠTITA PRIVATNE IMOVINE

Raporti Vjetor 2014

e themeluar nga rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 - established by UNMIK Regulation 2006/10 - osnovana pod UNMIK Uredbom 2006/10
e përkrahur nga - supported by - podržavaju



PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave

Hyrje

1. Përmbledhje ekzekutive

2. Korniza Ligjore

- 2.1. Baza ekzistuese ligjore që rregullon Agjencinë

3. Përshkrim i institucionit

- 3.1. Mandati
- 3.2. Mandati shtesë i trashëguar nga DÇPB

4. Fushëveprimi që mbulon institucioni

- 4.1. Fushëveprimtaria
- 4.2. Struktura Organizative
- 4.3. Sekretaria Ekzekutive
 - a. Drejtori Ekzekutiv
 - b. Zëvendësdirigjori Ekzekutiv
 - c. Menaxhmenti dhe personeli mbështetës
- 4.4. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK)
- 4.5. Bordi Mbikëqyrës
- 4.6. Burimet Njerëzore, personeli dhe aftësimi profesional
 - a. Pasqyra e punonjësve të AKP-së
 - b. Punonjësit ndërkombëtarë
 - c. Trajnimi i stafit
- 4.7. Asetet
 - a. Çfarë asete ka në posedim institucioni
 - b. Cilat janë planet për asete të reja

5. Aktivitetet për periudhën raportuese

- 5.1 Projekt Dokumenti i AKP-së 2011 – 2013
- 5.2 Statistikat për Numrin e Kërkesave të Regjistruara në AKP
- 5.3 Njoftimi për Kërkesat
- 5.4 Publikimi i Kërkesave
- 5.5 Qasja në të dhënat pronësore dhe përpunimi i kërkesave
- 5.6 Vendosja e kërkesave nga Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK)
- 5.7 Statistikat për Kërkesat e Vendosura nga KKPK
- 5.8 Zbatimi
 - a. Shpërndarja e Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
 - b. Shpërndarja dhe Zbatimi i Aktgjyqimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës për ankesat kundër vendimeve të KKPK-së
 - c. Zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
 - d. Kërkesat nga Zyrtat Kadastrale Komunale

- e. Kërkesat nga Agjencia Kadastrale e Kosovës
- f. Kërkesat e pranuar nga institucionet tjera
- 5.9 Zbatimi i Skemës së Kompensimit
- 5.10 Mbyllja e Kërkesave
- 5.11 Ndërmjetësimi
- 5.12 Administrimi i Pronës, Skema vullnetare e qirasë dhe aktivitetet e dëbimit
 - a. Administrimi i Pronës
 - b. Skema e Qiradhënies Vullnetare
 - c. Aktivitetet e Dëbimit
 - d. Rastet e ri-uzurpimit serik
- 5.13 Veprimtaritë informative dhe shpërndarja e informatave për publikun
 - a. Transparenca dhe Informimi
 - b. Bashkëpunimi në mes Agjencive

6. Sfidat e institucionit / rekomandimet

- 6.1 Sfidat e vitit paraprak
- 6.2 Synimet Operative dhe Treguesit e Performancës

7. Raporti financiar

- 7.1 Financimi
- 7.2 Zbatimi i Buxhetit
- 7.3 Vlerësimi i donatorëve

8. Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

9. Shtojcat

- Shtojca A - Struktura organizative e AKP-së
- Shtojca B - Statistikat rreth vendosjes së kërkesave deri në dhjetor 2014
- Shtojca C - Buxheti i AKP-së për 2014
- Shtojca D - Buxheti i rishikuar i AKP-së për 2014
- Shtojca E - Pasqyra e shpenzimeve të Buxhetit të AKP-së për vitin 2014
- Shtojca F - Pronat nën administrimin e AKP-së sipas rajoneve dhe komunave

Ngjarjet kryesore gjatë vitit 2014

LISTA E SHKURTESAVE

NJPK	Njësiti për Përpunimin e Kërkesave
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit
ABF	Anëtari i Bashkësisë Familjare
DÇPB	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
KKPB	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar
PZH	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
KKPK	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
Autorizim	Autorizim
BDP	Bartësi i së Drejtës Pronësore
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administrim në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

“...Kthimi i të drejtave pronësore në Kosovën e pasluftës ishte kritik për kthimin e pronave të banimit, mbrojtjen e të drejtave [pronësore] dhe forcimin e pajtimit. Në këtë kuptim, e themeluar si një instrument i përkohshëm i drejtësisë, AKP-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit në Kosovë pas konfliktit të viteve 1998-1999.”

Kjo që u theksua më sipër është pjesë e vlerësimit përfundimtar të AKP-së për periudhën 2006-2014, të bërë në emër të partnerëve të Agjencisë.

AKP-ja në vetvete është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Pavarësisht pavarësisë së vet institucionale, Qeveria, partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë janë duke luajtur një rol jetik në mbikëqyrjen dhe punën e përditshme të saj.

AKP-ja përbëhet nga tri organe kryesore, përkatësisht Sekretaria Ekzekutive, Komisioni i pavarur kuazi-gjyqësor për Kërkesa Pronësore (KKPK) dhe Bordi Mbikëqyrës – ky i fundit i përbërë nga përfaqësues të Qeverisë dhe partnerë ndërkombëtarë, i cili siguron mbikëqyrje administrative, orientim të përgjithshëm dhe udhëzime për politikën. KKPK-ja ndihmohet në kryerjen e funksioneve të saj vendimmarrëse nga stafi mbështetës ligjor dhe administrativ i EULEX-it të cilët janë caktuar për Zyrën e KKPK-së.

Në teren AKP-ja ka një prani aktive nëpërmjet zyrave të saj rajonale në pesë rajonet e Kosovës, ndërsa punët e AKP-së në Serbi kryhen përmes Zyrave Pronësore të UNHCR-së në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit (MiM) në mes AKP-së dhe UNHCR-së.

Pranimi i kërkesave në AKP është mbyllur më 3 dhjetor 2007 dhe deri në fund numri i kërkesave të regjistruara ishte 42.749. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së në muajin dhjetor 2014 ka përfunduar me sukses procesin e pranimit, regjistrimit dhe të përpunimit për vendosjen e të gjitha kërkesave të paraqitura në AKP.

KKPK-ja ka mbajtur gjashtë seanca gjatë periudhës raportuese, duke vendosur për 2,604 kërkesa nga të cilat, 2381 ishin kërkesa të reja dhe 223 kërkesa të shfuqizuara

më herët. 972 kërkesa të reja janë kontestuar nga uzurpuesit/palët përgjegjëse të cilët i janë drejtuar zyrës së AKP-së pasi prona ishte notifikuar dhe publikuar.

Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja ka pranuar 353 ankesa kundër vendimeve të KKPK-së dhe 12 kërkesa për korrigjime tekstuale. 327 ankesa (duke përfshirë disa ankesa të pranuar në vitin 2013) janë dërguar në Gjykatën Supreme për rishqyrtim. Gjykata Supreme i ka vendosur 183 ankesa, nga të cilat 122 janë refuzuar dhe 61 të tjera janë miratuar.

AKP-ja ka pranuar 1,712 kërkesa për administrim të pronave, 420 kërkesa për riposidim të pronave dhe 363 kërkesa për mbyllje të lëndëve. 1,283 kërkesa për administrim të pronave janë përpunuar dhe janë dërguar në Njësinë e Administrimit të Pronave (NAP). Janë përpunuar 206 lëndë për riposidim të pronave dhe 299 kërkesa janë dërguar për mbyllje të lëndëve me kërkesë të paraqitësve të kërkesave. Numri i përgjithshëm i vendimeve të zbatuara të KKPK-së gjatë periudhës raportuese është 9,357.

Gjatë periudhës së raportimit, 1,127 prona të reja janë marrë nën administrim të AKP-së. Gjatë periudhës raportuese, mesatarisht 12,919 prona janë administruar nga AKP-ja, ku bartësit e të drejtave pronësore/pronarët kanë paraqitur kërkesa për ndërprerjen e administrimit të pronave për 328 prona.

Skema e qiradhënies vullnetare e AKP-së zbaton kërkesat e AKP-së dhe DÇPB-së të miratuara dhe me kërkesën e paraqitësve të suksesshëm të kërkesave. Në vitin 2014, 1,482 prona janë përfshirë në këtë skemë vullnetare të qirasë. Deri në fund të periudhës së raportimit, gjithsej 4,527 prona ishin pjesë e skemës vullnetare të qirasë me 1,167 kontrata aktive të qirasë.

Gjatë periudhës së raportimit, 570,131.93€ janë mbledhur nga qiraja, nga të cilat 465,818.28€ u janë bartur bartësve të identifikuar të të drejtave pronësore; 46,721.05€ mbahen si depozitë për pronarët e paidentifikuar dhe 25,485.43€ mbahen si depozita të sigurisë. Shuma prej 23,139.23€ ishte e rezervuar për të mbuluar shpenzimet administrative të zbatimit të skemës.

Gjatë vitit 2014, Njësia e Dëbimeve e AKP-së ka planifikuar 2,384 dëbime. Nga këto, 836 dëbime fizike janë ndërmarrë nga Njësia e Dëbimeve me mbështetjen e Policisë së Kosovës; 117 ishin për riposëdime, 402 për uzurpim të kundërligjshëm, 75 për mospagesë të qirasë dhe 241 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira, ndërsa është rihapur 1 lëndë.

Nga muaji mars 2014, dëbimet në veri të Mitrovicës janë rinisur pas negociatave të shumta me Policinë e Kosovës. Që atëherë, disa dëbime janë kryer me sukses me ndihmën e Policisë së Kosovës. Numri i përgjithshëm i dëbimeve në pritje deri në muajin dhjetor 2014 në nivel të Kosovës është 669.

Gjatë vitit 2014, 22 raste të ri-uzurpimeve janë iniciuar në prokuroritë përkatëse, nga gjithsej 355 raste të iniciuara. Nga këto, 158 raste janë vendosur nga gjykatat përkatëse komunale kurse 197 raste janë në pritje në prokuroritë apo gjykatat komunale. Për më tepër, AKP-ja ka kërkuar arrestimin e 13 personave për uzurpim të paligjshëm.

AKP-ja ka krijuar një procedurë standarde operative për ndërmjetësim, të bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi. 31 anëtarë të stafit të AKP-së i janë nënshtruar trajnimit të ndërmjetësimit të mbështetur nga Qeveria Britanike. Deri tani, AKP-ja ka identifikuar 28 raste për ndërmjetësim në bazë të kërkesave të palëve apo siç është urdhëruar nga KKKP-ja.

Si pjesë e mandatit të vet të trashëguar nga DÇPB, Sekretaria Ekzekutive administron pronat e braktisura të banimit. Në vitin 2014, 15 prona të braktisura janë marrë “ex officio” nën administrim të AKP-së - që arrin në 314 prona të braktisura e të cilat janë ende nën administrim të AKP-së. Që nga muaji prill 2009, AKP-ja është duke zbatuar një strategji me të cilën ajo tenton të identifikojë bartësit e ligjshëm të të drejtave pronësore për t’iu mundësuar atyre që të marrin kontrollin e pronave të tyre.

Në lidhje me “Skemën e Kompensimit” - e cila ka për qëllim sigurimin e rikompensimit për kategori të caktuara të paraqitësve të kërkesave në DÇPB që janë lënë pa mjete juridike - AKP-ja iu ka dërguar një letër të gjithë partnerëve duke iu ofruar një propozim për financimin e skemës. Çështja paralelisht i ishte drejtuar Qeverisë së Kosovës duke kërkuar fonde të nevojshme për zbatimin e skemës. Një seri takimesh janë mbajtur dhe konsultime të

mëtejshme janë planifikuar për të krijuar momentin e nevojshëm për të gjetur një zgjidhje. Janë gjithsej 143 vendime të KKP-së që duhet të zbatohen përmes kompensimit, me shumën e kompensimit e cila arrin në 3.2 milionë euro. Pavarësisht përpjekjeve të saj më të mira, deri më tani Agjencia nuk ka qenë në gjendje që të marrë fondet e nevojshme, dhe pa fonde të tilla, vendimet e KKP-së nuk mund të zbatohen dhe të mbyllen plotësisht.

Në vitin 2014, dhe në mënyrë të vazhdueshme, AKP-ja ka zëvendësuar stafin vendor dhe ndërkombëtar në përputhje me nevojat e organizatës. Zëvendësimet janë bërë deri në qershor. Nga qershori e tutje, megjithatë, AKP-ja është përballur me vështirësi financiare që lidheshin me financimet nga donatorët dhe të gjitha rekrutimet kanë mbetur pezull.

Zyra e Prokurimit me sukses ka përmbyllur 60 prokurime në vitin 2014. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik (04 / L042). Ia vlen të theksohet se gjatë vitit 2014, Agjencia nuk ka pranuar asnjë ankesë prokurimi nga asnjë operator ekonomik e as nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

Duke qenë institucion i përkohshëm, aktualisht AKP-ja është afër përfundimit të mandatit të vet të tanishëm me që të gjitha kërkesat e paraqitura janë vendosur, ku tani Agjencia është duke hyrë në gamën e plotë të zbatimit të vendimeve - fazë e cila pritet të zgjasë më pak se 18 muaj. Përveç fokusit të ri të organizatës, Agjencia është përballur me sfida të tjera kritike në vitin 2014. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv ndërkombëtar të Agjencisë ka përfunduar në muajin gusht 2014 ndërsa Zëvendës Drejtori Ekzekutiv ka dhënë dorëheqje në muajin korrik 2014, dhe asnjëri prej tyre nuk ka mundur të zëvendësohet për shkak të vonesës së konstituimit të Kuvendit dhe Qeverisë së re të Kosovës. Në kohën e raportimit, AKP-ja është akoma duke u udhëhequr nga një ushtruese e detyrës së Zëvendës Drejtorit, e cila në bashkëpunim me stafin e mbetur kanë siguruar punën e vazhdueshme dhe zbatimin e mandatit të AKP-së.

Nga pesë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, vetëm 3 anëtarët ndërkombëtarë kanë mandate të vlefshme, ndërsa mandati i dy anëtarëve vendorë ka skaduar më 15 nëntor 2014. Si rrjedhojë dhe gjatë dy muajve të fundit të periudhës së raportimit, Bordi Mbikëqyrës i AKP-së ka funksionuar pa dy anëtarët vendorë në pritje të emërimit nga Kuvendi i ri i konstituuar i Kosovës.

Sa i përket qëndrueshmërisë financiare, Agjencia Kosovare e Pronës më herët ka qenë e mbështetur nga buxheti i Kosovës, si dhe burime të tjera; përkatësisht nga një numër i organizatave dhe partnerëve ndërkombëtarë. Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja megjithatë, është sfiduar nga paqëndrueshmëria financiare, në veçanti sa i përket donacioneve ndërkombëtare. Për shkak të pa parashikueshmërisë financiare, një numër i stafit profesional, kryesisht juristë me përvojë në fushën e të drejtave pronësore, kanë dhënë dorëheqjen dhe janë larguar nga AKP-ja.

Në përpjekje për t'iu dhënë informacione institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, AKP-ja është takuar rregullisht me aktorë të tjerë të fushës së të drejtave pronësore, duke përfshirë mes tjerash, UNHCR, OSBE dhe OJQ të ndryshme, në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin e punës së vet dhe rëndësinë e saj për ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Për këtë qëllim, AKP-ja është takuar gjithashtu me zyrtarë të Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Zyrtarët e AKP-së për më tepër, kanë marrë pjesë rregullisht në takime, punëtori dhe seminare brenda dhe jashtë Kosovës, të organizuar nga organizatat dhe OJQ-të që kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave pronësore dhe procesin e kthimit.

AKP-ja me këtë rast dëshiron të shprehë mirënjohjen e vet për të gjitha institucionet, organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë që kanë kontribuar dhe ndihmuar AKP-në, duke siguruar përfundimin me sukses të elementit të vendosjes së mandatit të AKP-së në vitin 2014. Agjencia në këtë mënyrë iu kërkon partnerëve të vet që të sigurojnë nivelin e njëjtë të mbështetjes për të siguruar zbatimin e plotë të mandatit të AKP-së, të cilin Agjencia është paraparë ta përfundojë gjatë vitit të ardhshëm.

KORNIZA LIGJORE

2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Agjencinë

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) është themeluar si Agjenci e Pavarur me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 me të njëjtin emër, e cila i ka dhënë Agjencisë një mandat të qartë dhe ndarje të roleve në mes tri organeve të saj kryesore, përkatësisht Sekretarisë Ekzekutive, Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) dhe Bordit Mbikëqyrës. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 është miratuar dhe ndryshuar me Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-079 i cili ka dhënë kuadrin legjislativ të zbatueshëm për aktivitetet e AKP-së (në tekstin e mëtejme legjislacioni i zbatueshëm). Ligji 03/L-079 është ndryshuar pjesërisht me Ligjin 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Duhet të theksohet se funksionimi i pavarur dhe natyra e Agjencisë nuk është ndryshuar nga asnjë prej këtyre ndryshimeve legjislative.

AKP-ja ka zhvilluar, miratuar dhe zbatuar një numër të madh të rregullave dhe procedurave të brendshme administrative të cilat e bëjnë punën e Agjencisë më funksionale dhe më efektive.

Nuk ka pasur asnjë ndryshim gjatë periudhës raportuese të bazës ligjore në të cilën Agjencia mbështetet për mandatin e vet. Për AKP-në është paraparë një mandat i ri me miratimin e Ligjit për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Krahassimit dhe Verifikimit të Pronave (AKKVP) - si pjesë e një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë për kthimin e regjistrave të zhvendosur kadastral. Ky ligj nuk është miratuar gjatë vitit 2014 siç pritej më parë, për shkak të shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës dhe zgjedhjeve të mëvonshme të parakohshme në Kosovë.

Miratimi më i shpejtë i Ligjit për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Krahassimit dhe Verifikimit të Pronave (AKKVP) do t'i hapte rrugën mandatit të ri për AKP-në dhe të përfundonte procesin e zbatimit të vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) në periudhën e parashikuar.

Vonesa në drejtim të mandatit të ri të AKKVP-së, megjithatë, nuk ka arritur të ndikojë në angazhimin profesional të AKP-së në përmbushjen e mandatit të vet aktual, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT



3.1 Mandati

AKP-ja funksionon si organ i pavarur në bazë të Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, edhe pse Qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë luajnë një rol të rëndësishëm në AKP përmes Bordit Mbikëqyrës. Mandati i AKP-së është të zgjidhë kërkesat për të drejta pronësore dhe të shfrytëzimit, me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës, për prona të paluajtshme private që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Pronat e paluajtshme private përfshijnë kategoritë e pronave banesore, bujqësore dhe komerciale. AKP-ja gjithsej ka pranuar mbi 42,749 kërkesa, nga të cilat rreth 90% janë pranuar përmes zyrave të AKP-në Serbi.

3.2 Mandati shtesë i trashëguar nga DÇPB

AKP-ja ka trashëguar disa detyra të cilat fillimisht ishin në kuadër të mandatit të paraardhëses së vet, Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB), e themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23. Përgjegjësitë e tilla përfshijnë zbatimin e vendimeve të mbetura të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) që ishin në pritje të zbatimit, dhe menaxhimin e pronave nën administrimin e DÇPB-së. Në ushtrimin e këtij aspekti të mandatit të vet, AKP-së i janë besuar të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së. Asetet fizike të DÇPB-së për më tepër, i janë bartur AKP-së dhe një numër i personelit të vet janë ri-caktuar për të kryer detyra të ngjashme brenda AKP-së.

FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

4.1 Fushë veprimtaria

AKP-ja punon në mënyrë të pavarur nga qeveria dhe organizatat lokale dhe ndërkombëtare në Kosovë, edhe pse Qeveria dhe partnerët luajnë një rol të rëndësishëm në AKP përmes Bordit Mbikëqyrës. AKP-ja përbëhet nga tri organe kryesore, përkatësisht Sekretarisë Ekzekutive, Komisionit të pavarur kuazi-gjyqësor të Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKPK) dhe Bordit Mbikëqyrës, i cili siguron mbikëqyrje administrative, orientim të përgjithshëm dhe udhëzime për politikën. Përveç kësaj, përmes zyrtarëve të veta rajonale, AKP-ja është e pranishme në pesë rajonet e Kosovës. Aktivitetet e AKP-së në Serbi tani kryhen përmes Zyrtarëve Pronësorë të UNHCR-së, të cilat janë themeluar pas nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit mes AKP-së dhe UNHCR-së. Prandaj, AKP-ja është i vetmi institucion në Kosovë i cili e ka ligjërisht përgjegjësinë për të marrë, regjistruar, dhe vendosur lidhur me kërkesat për pronat private në Kosovë që bien në kuadër të mandatit të institucionit.

4.2 Struktura organizative¹

AKP-ja përbëhet nga tri organe kryesore, përkatësisht:

Sekretarisë Ekzekutive;

KKPK “kuazi-gjyqësor i pavarur”; dhe

Bordit Mbikëqyrës, i cili siguron mbikëqyrje administrative, udhëheqje të përgjithshme dhe udhëzime të politikave.

Sekretaria Ekzekutive, nëpërmjet zyrtarëve rajonale të saj, është e pranishme në pesë rajonet e Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Prizren). AKP-ja më herët kishte zyre edhe në Mal të Zi dhe Maqedoni. Ndonëse këto zyra janë përdorur fillimisht si vende për pranimin e kërkesave, ato tani funksionojnë si pika në terren, ku palët në procedurat e AKP-së mundën p.sh. të paraqesin dokumentacion shtesë dhe të marrin vendimet lidhur me kërkesat e tyre. Aktivitetet e AKP-së në Serbi tani ndërmerren nga Zyrtarët Pronësorë të UNHCR-së, të cilat janë themeluar në bazë të një memorandumi të mirëkuptimit (MiM) të nënshkruar në mes AKP-së dhe UNHCR-së në Prishtinë më 19 gusht 2009, dhe përtëritja e tij në nëntor 2012 dhe nëntor 2013 (për një periudhë prej një viti në të dy rastet).

4.3 Sekretaria Ekzekutive

Përgjegjësia e parë kryesore e Sekretarisë Ekzekutive ishte mbledhja dhe regjistrimi i kërkesave. Pranimi i kërkesave është mbyllur më 3 dhjetor 2007, dhe pas përfundimit të regjistrimit të kërkesave të mbledhura më 29 shkurt 2008, ka pasur 38,335 kërkesa të parashtruara. Sekretaria Ekzekutive pastaj ka vazhduar përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave të regjistruara para se ato t'i referoheshin KKPK-së. Përpunimi dhe shqyrtimi përfshijnë këto aktivitete:

- *njoftimi i uzurpuesve të pronave të kërkuara dhe publikimi i kërkesave për palët e interesuara;*
- *publikimi i kërkesave;*
- *verifikimi i dokumenteve;*
- *mbledhja e dëshmimeve dhe mbajtja e intervistave me palët në kërkesë;*
- *shkëmbimi i dëshmimeve të palëve në kërkesa kontestuese;*
- *përgatitja e dokumenteve me shkrim që kanë të bëjnë me kërkesat; dhe*
- *referimi i kërkesave KKPK-së për vendimmarrje.*

AKP-ja ka mandat shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të vendimeve përfundimtare të KKPK-së dhe aktgjykimeve të shkallës së dytë të Panelit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Agjencisë Kosovare të Pronës. Mjetet juridike të zbatimit që janë në kuadër të mandatit përfshijnë, por nuk janë të kufizuara për të marrë prona nën administrimin e AKP-së, riposedim, konfiskim dhe shkatërrim të ndërtimeve pa leje, ankand, kompensim dhe të marrëveshjeve të qirasë, ku të gjitha lehtësojnë dhe sigurojnë kthimin e pronave tek bartësit e ligjshëm të të drejtave pronësore.

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv, të mbështetur nga personeli i Zyrës Ekzekutive, udhëheqin Sekretarinë Ekzekutive të AKP-së.

Sipas Ligjit 03/L-079 (të ndryshuar), Kryeministri propozon Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive për emërimin e tyre nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në pajtim me ndryshimet e bëra me Ligjin 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, vazhdojnë sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit.

a. Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ishte ri-propozuar nga Kryeministri më 28 mars 2013 me mandat deri më 31 gusht 2014. Drejtori i mëparshëm Ekzekutiv i AKP-së, z. Marian Nieora, pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës dhe në bazë të Ligjit 04-L-115 mbi “ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës”, ka përfunduar mandatin e tij më 31 gusht 2014. Për shkak të vonesës në konstituimin e Kuvendit dhe qeverisë së re pas zgjedhjeve të përgjithshme, nuk pati asnjë emërim të ri të Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së gjatë 2014.

b. Zëvendës Drejtori Ekzekutiv

Z. Xhevat Azemi, i emëruar më parë si Zëvendës Drejtor Ekzekutiv nga Kuvendi me propozim të Kryeministrit më 30 shtator 2010, dha dorëheqjen nga posti i tij më 5 korrik 2014. Më pas, më 29 korrik 2014, Bordi Mbikëqyrës emëroi znj. Florije Kika si Ushtruese të Detyrës së Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv. Ajo vazhdon të kryejë detyrat e saj derisa të emërohet një Zëvendës Drejtor i ri Ekzekutiv i AKP-së. Sipas ligjit në fuqi, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Kuvendi i Kosovës me propozimin e Kryeministrit, megjithatë, për të njëjtat arsye si çështja e Drejtorit Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv nuk ka mundur të emërohet nga Kuvendi në vitin 2014.

Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Sekretarinë Ekzekutive para Bordit Mbikëqyrës dhe gjithashtu i ofron këtij të fundit shërbimet e sekretarisë. Kjo përfshin organizimin e takimeve, përgatitjen e agjendave dhe procesverbalet e mbledhjeve, shpërndarjen e dokumenteve dhe informacioneve dhe monitorimin e veprimeve pasuese në lidhje me udhëzimet e pranuar. Në mungesë të Drejtorit Ekzekutiv në gjysmën e dytë të vitit 2014 (gusht-dhjetor 2014), Sekretaria Ekzekutive u përfaqësua nga ushtruesja e detyrës së Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv në mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës dhe takimet e tjera të brendshme dhe të jashtme.

Sekretaria Ekzekutive e AKP-së është treguar e suksesshme në përmbjlljen e procesit të pranimit, regjistrimit dhe procedimit për vendimmarrje të 42,749 kërkesave të paraqitura në AKP.

c. Menaxhmenti dhe personeli mbështetës

Më poshtë janë njësitë kryesore operative të AKP-së që merren me përpunimin dhe zbatimin kërkesave:

Zyrat Rajonale;
Njësia e Informimit dhe Notifikimit;
Njësia e Verifikimit të Dokumenteve;
Njësia e Menaxhimit të Dosjeve dhe të Dhënave;
Njësia e Përpunimit të Kërkesave;
Zyra e KKPK-së;
Njësia e Implementimit;
Njësia e Administrimit të Pronave;
Njësia e Dëbimeve, dhe
Njësia e Mbylljes së Lëndëve.

Funksionet dhe përgjegjësitë e këtyre njësive janë jetike për aftësinë e Agjencisë për të përmbushur mandatin e vet të përpunimit, vendosjes dhe zbatimit të kërkesave. Ka njësi të tjera që, edhe pse jo të përfshira drejtpërsëdrejti në përpunimin dhe zbatimin e kërkesave, gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm dhe integral në AKP.

Njësia e Administratës në AKP ofron mbështetje logjistike, shërbime të transportit, menaxhimit të ndërtesës, shërbime të sigurisë, menaxhimit të aseteve, shërbime të furnizimit dhe arkivimit për Zyrën Qendrore dhe Zyrat Rajonale.

AKP-ja përdor teknologji moderne, dhe përpunimi i kërkesave është i kompjuterizuar në masë të madhe. Njësia TI-së është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes së përgjithshme teknike dhe mban një mjedis të qëndrueshëm elektronik të punës. Për të lehtësuar përpunimin e kërkesave, zhvillimi i menaxhimit të të dhënave dhe aplikacioneve bëhet në bashkëpunim me përdoruesit e fundit dhe zhvillimi dhe përditësimi i aplikacioneve bëhet nëpërmjet identifikimit dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja. Trajnimi i stafit për përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve software bëhet po ashtu nga Njësia e TI-së.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm në AKP-së është përgjegjës për të siguruar menaxhmentin e lartë se sistemet e kontrollit të menaxhimit që aplikohen në AKP janë të përshtatshëm dhe punojnë në mënyrë efektive. Auditimi i brendshëm bën vlerësim të pavarur dhe objektiv të aktiviteteve të njësive të cilat i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe ofron analiza, rekomandime, këshilla dhe informata për udhëheqësit e njësive lidhur me aktivitetet e shqyrtuara. Kjo përf-

shin promovimin e kontrolleve efektive me kosto të arsyeshme. Njësia e Auditimit të Brendshëm kryen një gamë të shërbimeve të auditimit duke përfshirë auditimet financiare, auditimet e përputhshmërisë, auditimet operative, auditimet e teknologjisë së informacionit dhe shërbimet e këshillimit.

Njësia e Përkthimeve në AKP-së punon në bashkëpunim me asistentët e gjuhës të siguruar nga EULEX që janë të përkushtuar për punën KKPK-së, dhe i ofron AKP-së shërbime përkthimi me shkrim dhe me gojë. Këtu përfshihen vendimet e KKPK-së, memorandume të ndryshme dhe korrespondenca, raporte dhe çdo përkthim tjetër që është i nevojshëm në kuadër të mandatit të AKP-së.

Departamenti i Prokurimit në AKP-së ndërmerr të gjitha aktivitetet e prokurimit të kërkuara nga AKP-ja në bazë të Ligjit Nr 04/L-042 të Prokurimit Publik dhe të Rregullave të Prokurimit Publik në Kosovë. Gjatë vitit 2014, Zyra e Prokurimit me sukses ka përfunduar 60 prokurime. Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë kryer në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik (04/L-042). Vlen të theksohet se gjatë vitit 2014, Agjencia nuk ka marrë asnjë ankesë nga ndonjë Operator Ekonomik, as nga OSHP-ja.

4.4. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK)

KKPK-së i është dhënë juridiksioni për të vendosur kërkesat e referuara nga Sekretaria Ekzekutive. Sipas Ligjit 03/L-079 (të ndryshuar), Kryetari i Gjykatës Supreme propozon tre anëtarët e Komisionit për emërimin e tyre nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në pajtim me ndryshimet e bëra me anë të Ligjit 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, do të vazhdojnë sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit.

Të tre anëtarët e KKPK-së janë ende me mandat funksional. Dy anëtarët ndërkombëtarë, z. Veijo Heiskanen dhe z. Norbert Wühler janë riemëruar si anëtarë të Komisionit më 27 gusht 2014 nga Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së në përputhje me Ligjin (nr. 04L/274) për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, ndërsa anëtari vendor i Komisionit, z. Adem Vokshi është emëruar nga Kuvendi i Kosovës si anëtar i KKPK-së më 11 prill 2014 për një mandat 1-vjeçar, d.m.th. deri më 11 prill 2015.

KKPK-ja është takuar gjashtë herë gjatë periudhës raportuese. Sekretaria Ekzekutive i siguron KKPK-së mbështetje administrative, teknike dhe ligjore. Në ushtrimin e funksioneve të veta gjyqësore, KPPK-ja ka mbështetje ligjore dhe administrative nga anëtarët e stafit të EULEX-it të cilët janë të caktuar për Zyrën e KKPK-së.

Anëtarët e KKPK-së janë:

Z. Veijo Heiskanen (Finlandë) është Kryetar i KKPK-së.

Z. Norbert Wühler (Gjermani) është anëtar ndërkombëtar i KKPK-së.

Z. Adem Vokshi (Kosovë) është anëtar vendor i KKPK-së.

Selia e KPPK-së është në Prishtinë. Ajo është e lejuar të ushtrojë funksionet e veta vendimmarrëse përmes seancave të mbajtura në Prishtinë apo gjetiu, apo të mbajë shqyrtimet përmes mjeteve elektronike sa herë që është e nevojshme. Seancat mbahen çdo dy muaj. Kryesuesi KPPK-së, në konsultim me anëtarët e tjerë të Komisionit, përcakton rendin në të cilin kërkesat duhet të referohen për vendosje dhe duke marrë parasysh informatat mbi vëllimin e punës të ofruara nga Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive. Kërkesat që ngrihen të njëjtat çështje juridike dhe dëshmuese futen së bashku në pako në kategoritë për vendosje dhe deritani, në përputhje me udhëzimet e KKPK-së, Sekretaria Ekzekutive ka referuar kërkesat në pako me lëndët si më poshtë:

KKPK-ja si rregull vendos për kërkesat në bazë të dokumenteve dhe dëshmimeve të tjera të shkruara. Palët ftohen të paraqesin në KPPK faktet dhe argumentet e tyre përmes Sekretarisë Ekzekutive dhe kanë të drejtë t'i u dërgohen provat dhe shkresat e palëve të tjera në kontest, dhe për të paraqitur provat dhe dokumentet si përgjigje. Palët nuk kanë të drejtë të menjëhershme për seancë dëgjimore nga KKPK nëse nuk ftohen për një gjë të tillë, meqë organizimet për pjesëmarrjen e mijëra paraqitësve të kërkesave do të shkaktonin harxhime të konsiderueshme të burimeve dhe të kohës, duke qenë kështu në kundërshtim me të drejtat e paraqitësve të kërkesave për mjete juridike brenda një periudhe të arsyeshme. Përveç kësaj, fakti që paraqitësit e kërkesave janë të zhvendosur gjithandej në Serbi, Maqedoni, Mali të Zi, potencialisht do të rezultonte me atë se vetëm disa paraqitës të kërkesave do të ishin në gjendje të ushtronin të drejtën për të marrë pjesë në seanca dëgjimore. Sa herë që KPPK, megjithatë, konsta-

ton se interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë, Komisioni mban seanca dëgjimore për të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë paraqitësit e kërkesave, palët përgjegjëse dhe dëshmitarët.

Gjatë periudhës së raportimit, janë mbajtur njëzetetë seanca dëgjimore. Të gjitha kërkesat janë vendosur në bazë të dosjes së kërkesës të referuar në KKPK, e cila përmban dëshmi dhe shkresa të paraqitësit të kërkesës dhe në kërkesat kontestuese dëshmi dhe shkresa të palës përgjegjëse, dëshmi të mbledhura nga Sekretaria Ekzekutive dhe raport të përpunimit të kërkesës.

Gjatë procesit të vendosjes kur KPPK-ja konstaton se informacioni shtesë është i nevojshëm për të vendosur çështjet e ngritura nga kërkesa, ai mund t'ia kthejë Sekretarisë Ekzekutive kërkesën me urdhrin që të ndërmarrë hetime shtesë në lidhje me kërkesën. Kjo zakonisht përfshin kontrollë dhe hulumtime shtesë për dokumente apo për intervistim të palëve në kërkesë.

Para se të vendoset një kërkesë, me kërkesë të paraqitësit të kërkesës dhe pas rekomandimit të Sekretarisë, KKPK-ja mund të miratojë masat e përkohshme mbrojtëse, duke përfshirë urdhrin e përkohshëm kur paraqitësi i kërkesës të ketë dëshmuar *prima facie* kërkesën dhe nëse këto masa të përkohshme nuk do të aprovoheshin, paraqitësi i kërkesës do të përballej me dëme të riparueshme.

Pas çdo seance, KKPK nxjerr udhëzime të përpunimit me të cilat i jepen udhëzime Sekretarisë Ekzekutive lidhur me prezantimin e duhur të kërkesave për vendosje nga ana e KKPK-së. Udhëzimet e Përpunimit kanë të bëjnë me çështje procedurale dhe thelbësore që dalin gjatë rrjedhës së përpunimit të kërkesave.

Komisioni mund të miratojë, të refuzojë apo të hedh poshtë një kërkesë dhe është i kufizuar nga kriteret e përcaktuara në vendimet e tij, përveç nëse ka arsye që e detyrojnë atë të shmanget nga ato parime. Komisioni mund të caktojë vetëm mjet ligjor që i është dhënë me legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të caktojë kosto që rrjedhin nga procedimet në të mirë ose në dëm të një pale në procedurë.

KPPK-ja mund të referojë çështje që dalin nga një kërkesë, dhe të cilat nuk janë brenda juridiksionit të tij apo pjesë të veçanta të kërkesave të tilla, nëse vendosja për ato pjesë të ndara nuk prek çështjet pronësore ose të drejtat e shfrytëzimit të pronës siç parashikohet

në legjislacionin në fuqi para një gjykate kompetente vendore ose tribunali administrativ.

KPPK-ja ka përcaktuar në jurisprudencën e vet se ai nuk ka juridiksion për të miratuar kompensim monetar. Në rastet kur paraqitësit e kërkesave kanë kërkuar kompensim për dëme materiale ose shfrytëzim të paautorizuar të pronës së kërkuar, përveç konfirmimit të pronësisë, KPPK-ja ka hedhur poshtë këtë aspekt të kërkesës, duke argumentuar se ai nuk ka juridiksion për të miratuar një ndihmë të tillë ligjore.

(Shtojca B e këtij raporti tregon një pasqyrë rreth kërkesave të vendosura deri më tani.)

4.5 Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës ka mandat për të mbikëqyrur punën e AKP-së dhe t'i ofrojë asaj mbikëqyrje administrative, orientim të përgjithshëm dhe udhëzime për rrjedhën e veprimit. Megjithatë, ai është i përjashtuar nga pjesëmarrja në procesin në të cilin KKPK-së shqyrton dhe vendos kërkesat. Sipas Ligjit Nr. 03/L-079 (i ndryshuar), Kryeministri propozon pesë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës për t'u emëruar nga Kuvendi i Kosovës. Në pajtim me ndryshimet me Ligjin 04/L-115, emërimet e bëra në përputhje me Kushtetutën, vazhdojnë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e emërimit. Anëtarët ndërkombëtarë të Bordit janë emëruar ose riemëruar nga ICR-ja më 22 gusht 2012 deri më 31 gusht 2014, ose deri në fund të mandatit të AKP-së për të vendosur kërkesat, cila do që ndodh më herët, dhe me autoritetin e vetëm për të mbikëqyrur çështjet që lidhen me mandatin e tanishëm të AKP-së. Duke pasur parasysh autoritetin e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274, për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, Përfaqësuesi i Posaçëm i BE-së ka lëshuar vendimet për vazhdimin e mandatit të Ambasadorit Ian Cliff dhe emërimin e Todd Christiansen, Shef i Sektorit Ekonomik në Ambasadën Amerikane, dhe Christiane Jaenicke, Këshilltare e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së, si anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të AKP-së deri më 31 gusht 2015 ose deri në fund të mandatit aktual të AKP-së për të vendosur kërkesat. Lidhur me anëtarët vendorë të Bordit, të propozuar nga Kryeministri, Kuvendi ka riemëruar një anëtar vendor të Bordit Mbikëqyrës më 15 maj 2012, dhe ka emëruar një anëtar të ri vendor në Bordin Mbikëqyrës.

Kuvendi i Kosovës, pas propozimit nga Kryeministri, me 15 nëntor 2013 ka riemëruar dy anëtarët vendorë të Bordit.

Nga pesë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës në kohën e raportimit, tre anëtarët ndërkombëtarë të Bordit janë me mandate të vlefshme, ndërsa mandatet e dy anëtarëve vendorë të Bordit kanë skaduar.

Anëtarët ndërkombëtarë të Bordit me mandate funksionale, të cilët janë emëruar në bazë të Ligjit (Nr. 04L/274) për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovë, janë:

1. Ian Cliff, kryetar, (i emëruar nga 27.08.2014 deri 01.04.2015)
2. Christiane Jaenicke, anëtare (e emëruar nga 27.08.2014 deri 31.08.2015)
3. Todd Christiansen, anëtar, (i emëruar nga 27.08.2014 deri 31.08.2015)

Ndërsa dy anëtarët vendorë të Bordit, mandati i të cilëve tashmë ka skaduar:

1. Ujup Krasniqi, anëtar (i emëruar më 15.11.2013 dhe ka skaduar më 14.11.2014)
2. Ismajl Osdautaj, anëtar (i emëruar më 15.11.2013 dhe ka skaduar më 14.11.2014)

Si pasojë, gjatë dy muajve të fundit të periudhës së raportimit, Bordi Mbikëqyrës në mungesë të një kuvendi të konstituuar ka funksionuar pa dy anëtarët e vet vendorë. Bordi Mbikëqyrës është takuar 10 herë gjatë periudhës së raportimit.

4.6 Burimet Njerëzore, personeli dhe aftësi profesionale

Njësia e Burimeve Njerëzore mban përgjegjësinë për personel dhe aftësi profesionale në AKP.

a.) Pasqyra e punonjësve të AKP-së është si më poshtë:

Numri i përgjithshëm i personelit që punon drejtpërsëdrejti për AKP-në dhe në mënyrë të tërthortë në mbështetje të mandatit të KPA-së është 276. Dy tabela me detaje të mëtejshme janë paraqitur më poshtë:

Stafi në vijim është siguruar nga donacionet në natyrë nga autoriteti financiar që është

paraqitur në shtyllën e parë dhe si të tillë nuk paguhet nga mjetet buxhetore të AKP-së:

Autoriteti financiar	Numri i Stafit Ndërkombëtar	Numri i Stafit Vendor
EULEX	5	6
Qeveria Britanike	1 (deri në fund të gushtit 2014)	
Qeveria Norvegjeze	3 (një nga korriku 2014)	
Qeveria Gjermane	1 nga shtatori 2014	
Zvicra	1 nga shtatori 2014	

Stafi në vijim është kontraktuar për të punuar për AKP-në dhe pagesa e tyre bëhet nga ndarjet buxhetore të AKP-së:

Autoriteti financiar	Numri i Stafit Ndërkombëtar	Numri i Stafit Vendor në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi
Fondi i Donatorëve	6 (1 deri në korrik 2014 i cili pastaj është kontraktuar përmes Qeverisë së Norvegjisë, dhe 3 të tjerë deri në fund të gushtit 2014)	184* (prej të cilëve: 3 tërësisht të financuar nga donatorët në Kosovë dhe 10 në Serbi, 1 në Mal të Zi, ndërsa nga korriku 2014 vetëm 4)
BKK		72

* 170 prej tyre marrin pagë bazë nga BKK.

	Numri i Stafit Ndërkombëtar	Numri i Stafit Vendor
Total	14	262

Menaxhmenti i AKP-së është një ekip i përzier i përbërë nga ndërkombëtarët që mbajnë 16% të posteve drejtuese dhe vendorët që mbajnë 84% të posteve drejtuese në njësitet dhe departamentet e ndryshme të AKP-së në Kosovë. Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja ka punësuar rreth 247 juristë vendorë, asistentë ligjorë, përkthyes, kontabilistë, ekspertë për kompjuterë dhe të TI-së dhe staf mbështetës administrativ. Ndryshimi në numrin e përgjithshëm të posteve është për shkak të dorëheqjeve dhe rekrutimeve të vazhdueshme.

AKP-ja ka njëkohësisht edhe 72 shërbyes civilë të cilët paguhën nga BKK, kriteret dhe kushtet e punësimit dhe të pagesës të tyre rregullohen me Ligjin për Shërbimin Civil. Stafi vendor i AKP-së në Kosovë paguhën me një pagë bazë nga Buxheti i Kosovës e cila plotësohet me fonde shtesë nga donatorët për të siguruar nivel të ngjashëm të pagës për aq sa stafi është paguar deri në fund të vitit 2008 dhe, në këtë mënyrë, punësimi dhe pagesa e tyre po ashtu rregullohet me politikat e personelit të stafit të AKP-së përveç Ligjit për Shërbimin Civil. Lidhur me konsulentët që punojnë në Zyrat Pronësore të UNHCR-së, punësimi i tyre është i rregulluar me politikat e stafit të UNHCR-së, kurse për stafin vendor në Mal të Zi, shfrytëzohet një kontratë e financuar tërësisht nga donatorët dhe aplikohen politikat e stafit të AKP-së. Në përputhje me ligjet e zbatueshme në lidhje me tatimet dhe pensionet, AKP-ja bën zbritjet e duhura nga paga bruto e stafit dhe ato zbritje i dërgon në Administratën Tatimore të Ministrisë së Financave të Kosovës dhe në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës sipas rastit.

b) Zyrtarët ndërkombëtarë janë sjellë në AKP përmes një marrëveshje me UNDP-në për t'i siguruar AKP-së pesë punonjës ndërkombëtarë. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi në muajin janar 2012, për një periudhë prej një viti dhe është vazhduar për të mbuluar edhe vitin 2013. Në muajin korrik 2013, pozita e koordinatorit rajonal u la e zbrazët dhe, rrjedhimisht, mbetën katër ndërkombëtarë me Marrëveshje Individuale Kontraktuese të UNDP-së. Në vitin 2014, vetëm një punonjës ndërkombëtar mbeti me kontratën e lartpërmendur të UNDP-së, dhe deri në fund të muajit qershor 2014, ky post pastaj u shndërrua në post të deleguar përmes një marrëveshje me Bankën Norvegjeze të Burimeve për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (NORDEM).

Përveç stafit ndërkombëtarë të lartpërmendur, pesë zyrtarë vullnetarë të OKB-së (UNV) janë rekrutuar në AKP përmes UNDP-së - 3 prej këtyre kontratave kanë skaduar në fund të muajit gusht 2014. Deri më 31 mars 2013, ICO ka emëruar Drejtorin Ekzekutiv të AKP-së, megjithatë, pas skadimit të mandatit të ICO-së, Drejtori i ri Ekzekutiv është emëruar nga Kryeministri në konsultim me Përfaqësuesin e Posaqëm të BE-së në bazë të nenit 5 për ndryshimin e nenit 27A paragrafi 4 i Ligjit për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës Nr. 04/L-115. EULEX-i gjithashtu mbështet mekanizmin e AKP-së

duke financuar në mes tjerash dy komisionerët ndërkombëtarë, Udhëheqësin e Zyrës së KKPK-së, dy zyrtarë ligjorë ndërkombëtarë, si dhe pesë vendorë nga stafi i EULEX-it.

Në bazë të një marrëveshje të mëparshme me Këshillin Norvegjez për Refugjatë, më 10 tetor 2010, Qendra Norvegjeze për të Drejtat e Njeriut (QNDNJ) dhe AKP-ja bënë një MiM për ta zbatuar nëpërmjet Bankës Norvegjeze të Burimeve për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (NORDEM), i cili financohet nga Qeveria Norvegjeze. Përmes këtij memorandum, dy postet e deleguara të rekrutuar nga NORDEM u vendosën në muajin janar 2011 për të punuar në Njësinë e Përpunimit të Kërkesave (NPK). Vazhdimi i këtyre dy posteve të deleguara deri në fund të 2012 u ra dakord nga NORDEM në muajin nëntor 2011 dhe është rënë dakord edhe për një vazhdim të mëtejshëm të pozitive të deleguara deri në fund të vitit 2013 dhe 2014.

Në vitin 2014 në baza të vazhdueshme, AKP-ja po kryente zëvendësimin e stafit vendor dhe ndërkombëtar për ato poste për të cilat ka pasur arsye të mjaftueshme nga menaxherët e tyre të linjës për zëvendësimin e tyre. Zëvendësimet kanë vazhduar vetëm deri në qershor. Nga qershori e tutje, AKP-ja është përballur me vështirësi financiare që lidhen me financimin nga ana e donatorëve, në këtë mënyrë duke i mbajtur pezull të gjitha rekrutimet.

Transferimi dhe sistematizimi i burimeve njerëzore në fusha të tjera të punës do të ndërmerret siç kërkohet, meqë koha e çdo transferimi do të varet nga progresi kundrejt planit të punës dhe punës së mbetur në njësitin ku paraqitet vendi i lirë. Kjo do të thotë se nuk do të ketë zëvendësim automatik të asnjë pozite që mbetet e lirë, meqë duhet të bëhet një analizë e situatës në atë kohë.

c) Trajnimi

Pas shpalljes së Ligjit 03/L-079 të gjithë nëpunësit vendorë të AKP-së, përfshirë edhe nëpunësit e financuar nga BKK-ja, kanë mundësi të marrin pjesë në trajnime të cilat organizohen nga Instituti Kosovar i Administratës Publike (IKAP). Disa nëpunësve u është ofruar mundësia dhe e kanë shfrytëzuar atë mundësi për të rritur aftësitë e tyre profesionale duke ndjekur këto trajnime.

Megjithëse AKP-ja përdorë teknologji moderne gjithëpërfshirëse, duke kompjuterizuar përpunimin e

kërkesave, prapëseprapë ajo varet shumë nga njohuritë njerëzore dhe në këtë aspekt punonjësit e AKP-së përfaqësojnë shtyllën e Agjencisë. Janë zhvilluar ekspertiza të rëndësishme në fushën e kthimit të pronave gjatë disa viteve duke filluar nga paraardhësi i AKP-së, DÇPB-ja, ku pjesa më e madhe e punonjësve janë transferuar në AKP, pas mbylljes së DÇPB-së, për të mbajtur aftësitë e tyre institucionale dhe profesionale. Është e rëndësishme që AKP-ja të ketë burime të vazhdueshme që të mbajë punonjësit me përvojë dhe profesionalizëm të rëndësishëm.

Gjatë periudhës raportuese, 37 punonjës vendorë të AKP-së janë trajnuar në fushat përkatëse të organizuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP).

Megjithatë, nevojat për trajnime avancuese dhe profesionale të stafit, veçmas atij vendor, të AKP-së janë të vazhdueshme edhe pse AKP-ja nuk ka mjete të cilat do të kishte mundësi t'i ndante për trajnime më të specializuara.

4.7. Asetet

Asetet e AKP-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 janë detajuar në vijim:

- Asetet me vlerë kapitale kane vlerën në libër 238,097.58 €
- Asetet me vlerë jo-kapitale kane vlerën në libër 83,173.27 €

Agjencia Kosovare e Pronës gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin 2015 ka planifikuar blerje të aseteve të Teknologjisë Informative, të cilat janë të nevojshme për realizimin e objektivave të AKP-së, por në momentin e aprovimit të buxhetit të vitit 2015, buxheti për blerjen e këtyre pajisjeve nuk është aprovuar. AKP-ja do të vazhdojë të kryejë aktivitetet e veta me pajisjet e teknologjisë informative, të cilat i ka në dispozicion por mos aprovimi i buxhetit për blerjen e pajisjeve të planifikuara të TI-së mund të ndikojë në realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të AKP-së.

AKP-ja është duke shfrytëzuar me qira një ndërtesë të selisë së vet në qendër të Prishtinës, për të cilën shpenzohet një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të saj. Këto hapësira janë megjithatë jo të kënaqshme, dhe AKP-ja po përballlet me mungesa të hapësirës të nevojshme për stafin e vet dhe hapësira për parking të automjeteve zyrtare. Duke iu siguruar një ndërtesë falas, p.sh. nga qeveria, do të lironte fonde të konsiderueshme nga buxheti i AKP-së të cilat do të mund të përdorehin për aktivitetet e Agjencisë.

Trajnimi	Nr. i nëpunësve që e kanë ndjekur trajnimin
E drejta e BE-se dhe zbatimi i saj	1
E drejta e qasjes në dokumente publike	2
Etika dhe antikorrupsioni në administratën publike	3
Funksionimi i Administratës shtetërore në RKS	2
Harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian	4
Komunikimi, konfliktet, ekipet dhe puna ekipore	2
Krijimi i kulturës së mentorimit në organizatën tuaj	2
Menaxhimi i kohës dhe delegimi	1
Menaxhimi i projekteve	2
Në fushën e BE-së	1
Ngjitja e efikasitetit në administratën publike	1
Procedurat administrative	2
Proceset dhe Procedurat për Auditim e Burimeve Njerëzore	1
Procesi i vetëvlerësimit në organizatë	2
Sistemi Informativ i Burimeve Njerëzore	2
Sjellje Organizative	1
Të drejtat e njeriut në Kosovë	2
Trajnimi fillesat për IPA2	1
Vendimmarrja dhe Motivimi	1
Virtualizimi në Institucionet e Kosovës	2
Windows 7 & Internet	2

Aktivitetet për periudhën raportuese

5.1 Projekt Dokumenti i AKP-së 2011 - 2013

Pas Vlerësimit të Donatorëve të AKP-së i cili është bërë në muajin tetor të vitit 2010, dhe pastaj zbatimi i rekomandimeve kanë kulmuar në përgatitjen e një projekt dokumenti për të mbuluar AKP-në nga viti 2011 deri 2013.

Rezultatet e paraqitura në projekt dokumentin fillestar janë:

Rezultati 1: Deri në dhjetor 2011 të kryhen të gjitha notifikimet, publikimet dhe verifikimet e mbetura të kërkesave të regjistruara.

Rezultati 2: Më së voni deri në gusht 2012 të përpunohen plotësisht të gjitha 30,662 kërkesat e mbetura dhe AKP-ja t'ia përcjellë KKPK-së për vendimmarrje (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2012).

Rezultati 3: Vendosja e të gjitha kërkesave të mbetura të kryhet nga KKPK deri në gusht 2012 (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2012).

Rezultati 4: Deri në gusht 2013 AKP-ja t'i shpërndajë dhe zbatojë me sukses të gjitha 41,102 vendimet e KKPK-së (me mundësi vazhdimi deri më 31 dhjetor 2013).

Rezultati 5: Pronat nën administrimin e AKP-së të vazhdojnë të menaxhohen në mënyrë efikase deri në dhjetor 2013.

Rezultati 6: Deri në dhjetor 2013 të merret dhe të zbatohet vendimi lidhur me të ardhmen e AKP-së pas vitit 2013 si një institucion tërësisht vendor i financuar nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës.

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB) ka financuar një projekt mbështetës të AKP-së duke shfrytëzuar konsulentët e njëjtë të cilët kanë bërë vlerësimin fillestar, për t'i siguruar AKP-së mbështetje të mëtejshme dhe në mënyrë të veçantë Bordit Mbikëqyrës. Ky projekt ka filluar në muajin nëntor 2011 me një rishikim të gjendjes aktuale dhe të përparimit të bërë sa u përket objektivave të parashtruara dhe financim-

it, të domosdoshëm për të përfunduar vendosjen dhe zbatimin e kërkesave. Rezultati kryesor i këtij projekti në vazhdim ishte përditësimi i projekt dokumentit 2011 – 2013. Raporti është lëshuar më 17 janar 2012 dhe përfshin rekomandimet në lidhje me çështjet operative dhe strategjike. Sekretaria Ekzekutive dhe Bordi Mbikëqyrës kanë adresuar rekomandimet e bëra dhe konkluzionet janë raportuar dhe pranuar në mbledhjen e donatorëve të AKP-së, të mbajtur më 16 maj 2012.

Vizita e dytë e konsulentëve është bërë ndërmjet 18 dhe 22 qershorit 2012. Raporti i dalë në përgjithësi ishte pozitiv, por megjithatë u theksua në veçanti se objektivat e përpunimit/vendosjes së lëndëve nuk ishin përmbushur sipas planit të punës dhe projekt dokumentit, dhe se kërkesat e mbetura jokontestuese po bëheshin më të ndërlikuara, ku përveç tyre kërkesat e shfuqizuara të mbetura do të duhej të ripërpunoheshin në tërësi, për më tepër, domosdoshmëria e ndarjes së kërkesave me qëllim të përpunimit të tyre, i shtohet numrit të përgjithshëm të kërkesave që duhej të përpunoheshin. Me qëllim të adresimit të dy pikave të para me një shqyrtim që është ndërmarrë nga juristët dhe koordinatorët të cilët aktualisht janë të punësuar, bazuar në kompleksitetin në rritje të kërkesave, është përcaktuar se numri i koordinatorëve në ekipin e kërkesave të pakontestuar nuk është adekuat për të siguruar që kërkesat e përpunuara nga juristët të mund të përpunohen në kohë të arsyeshme. Në vazhdimësi të kësaj, është bërë një vlerësim i stafit shtesë të nevojshëm për të siguruar përfundimin e fazës së vendosjes deri kah mesi i vitit 2013 dhe i është paraqitur ZZB-së. Për shkak të vështirësive financiare, ky projekt i stafit shtesë u desh të pezullohej, megjithatë është rënë dakord në Bordin Mbikëqyrës se nëse do të vihejshin në dispozicion fonde shtesë, atëherë projekti për staf shtesë do të rishikohej. Për të reduktuar ndarjen e kërkesave, Sekretaria Ekzekutive ka diskutuar çështjen me Komisionin. Vizita e fundit e konsulentëve është bërë nga 21 deri më 24 tetor 2013 dhe raporti është lëshuar më 11 nëntor 2013. Në raport është sugjeruar që vendimmarrja në të gjitha kërkesat e paraqitura të përfundojë në qershor 2014, ndërsa administrimi dhe zbatimi i vendimeve të vazhdojë edhe pas kësaj date.

Sa i përket rezultatit 1, AKP ka përfunduar tërë notifikimin, publikimin dhe verifikimin e kërkesave të regjistruara.

Sa u përket rezultateve 2 dhe 3, të gjitha kërkesat i janë referuar KPKK-së dhe janë vendosur nga ai.

Sa i përket rezultatit 4, AKP është duke vazhduar me zbatimin dhe gjer më sot 40,903 vendime i janë dorëzuar paraqitësve të kërkesave dhe 3,381 palëve përgjegjëse apo uzurpuesve aktual. Prej tyre, nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave janë pranuar 15,152 kërkesa për administrim, 1,996 kërkesa për riposëdim dhe 1,862 kërkesa për mbylljen e rastit. Për t'u siguruar që paraqitësit e kërkesave të përgjigjen duke i paraqitur kërkesat për zbatim në kohën e duhur, paraqitësve të kërkesave u është dhënë afati prej gjashtë muajsh, gjë që nuk ka qenë rasti më herët, për të paraqitur kërkesën për administrim. Në rastet kur nuk respektohet ky afat, ata mund të kërkojnë vetëm mbylljen e rastit apo riposëdimin e pronave të tyre. Paraqitësit e kërkesave, të cilëve në rastet e ngjashme me herët lëndët u janë mbyllur si jo-bashkëpunues, janë kontaktuar dhe u është ofruar afati prej tre muajsh për të paraqitur kërkesat e tyre.

Sa i përket rezultatit 5, administrimi i pronave dhe përfshirja e tyre në Skemën e Qiradhënies Vullnetare është duke vazhduar.

Sa i përket rezultatit 6, nuk janë bërë zhvillime në këtë drejtim. Çështja do të raportohet në kohën e duhur.

Vlerësimi i AKP-së nga konsulentët e jashtëm ka kulmuar me raportin "Vlerësimi Përfundimtar i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) 2006-2014" të paraqitur më 3 shtator 2014. Të gjeturat në raport janë nxjerrë nga vërtetimet dhe të dhënat e mbledhura gjatë disa misionëve që përfshijnë vlerësimin 6 mujor më 2010 dhe katër misione (2011-2013) që kanë të bëjnë me mbështetjen e mandatit të AKP-së të autorizuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (ZZB). Duke ditur edhe mbështetjen afatgjate financiare të DÇPB-së dhe AKP-së nga ZZB, raporti mund të konsiderohet si vlerësimi përfundimtar për rëndësinë institucionale, efikasitetin dhe efektshmërinë e AKP-së.

Raporti fillimisht paraqet që... *"sa i përket efikasitetit, AKP-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë institucion i rëndësishëm në Kosovë. Paraqitësit e kërkesave në përgjithësi janë mirënjohës për shërbimet dhe ekzistimin e AKP-së. Duke pasur parasysh mandatin e AKP-së si instrument*

ligjor për kthimin në masë të pronave, mund të arrihet në përfundim që gjer më sot nuk ka pasur alternativë të mundshme përveç AKP/KKPK-së për të kthyer të drejtat pronësore në mënyrë masive. Gjithashtu, gjatë punës së saj AKP-ja ka krijuar reputacion solid profesional. Është konsideruar transparente, bashkëpunuese dhe përgjegjëse për të ngritur nevojat e paraqitësve të kërkesave dhe ato institucionale".

Konsulentët vërejnë se... "që nga fillimi i saj më 2006, AKP-ja dhe donatorët e saj mbështetës kanë demonstruar aftësinë për t'u adaptuar në një varg rrethanash kontekstuale e sfiduese. Kthimi i të drejtave pronësore në Kosovën e pas konfliktit ishte kritike për zgjidhjen e kthimit të pronave banesore, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe përforcimin e pajtimit. Në këtë kup-tim, e themeluar si një instrument i përkohshëm i drejtësisë, AKP-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit në Kosovë pas vitit 1998-99".

5. 2 Statistikat për Numrin e Kërkesave të Regjistruara në AKP

Në datën e mbylljes së pranimit të kërkesave më 3 dhjetor 2007, ishin të regjistruara rreth 38,335 kërkesa. Gjatë përpunimit të kërkesave ishte zbuluar që një numër i kërkesave të cilat ishin paraqitur si kërkesa individuale për ngastra të shumëfishta dhe të cilat në kohën e paraqitjes ishin përshkruar si afër njëra-tjetrës apo të ngjitura në fakt ishin tërësisht të ndara, fakt ky që është zbuluar vetëm pas notifikimit të vet kërkesave për të cilat kërkohej identifikimi dhe inspektimi i ngastrës/ngastrave në fjalë. Si rezultat dhe deri në përfundimin e periudhës së raportimit, numri i kërkesave të regjistruara është rritur në 42,749, (53 kërkesa më shumë gjatë periudhës së raportimit). Megjithatë rritja e numrit nuk përfshin kërkesa të reja të paraqitura pas mbylljes së afatit, por vetëm ndarjen dhe ri-regjistrimin e kërkesave tashmë të paraqitura.

Rreth 37,474 kërkesa (88.5% nga numri i përgjithshëm i pranuar) kanë të bëjnë me tokën bujqësore, ndërsa 951 kërkesa (2.2%) kanë të bëjnë me pronat komerciale dhe 3,922 (9.3%) kanë të bëjnë me pronën banesore. Në 98,8% të kërkesave, paraqitësit e kërkesave kërkojnë të drejtën e pronësisë në pronën e kërkuar. Numri më i madh i kërkesave të paraqitura ka të bëjë me pronat, të cilat gjenden në rajonin e Pejës (34.4%). Tabelat e mëposhtme paraqesin natyrën, ndarjen gjeografike dhe numrin e kërkesave të paraqitura.

NATYRA E TË DREJTËS SË KËRKUAR PRONËSORE

Rajoni/Kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e Kërkesave
Pronësia	9329	4621	14559	7146	6571	42226	98.8
Të Drejtat për Shfrytëzim	48	66	148	185	76	523	1.2
Kompensimi	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	9377	4687	14707	7331	6647	42749	100
% e Përgjithshme e Kërkesave	22.0	11.0	34.4	17.0	15.6	100	100

KLASIFIKIMI I PRONAVE

Rajoni/ Lloji i pronës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e Kërkesave
Banesore	720	450	1548	891	556	4165	9.6
Komerciale me ndërtesa	107	120	262	348	106	943	2.2
Bujqësore	8550	4117	12897	6092	5985	37641	88.2
Gjithsej	9377	4687	14707	7331	6647	42749	100
% e Përgjithshme e Kërkesave	21.9	10.9	34.3	17.3	15.6	100	100



Komuna	Të paraqitura	%
Deçan	728	1.69
Dragash	6	0.01
Ferizaj	3156	7.39
Fushë Kosovë	405	0.94
Gjakovë	796	1.79
Gjilan	1729	4.00
Glllogofc	58	0.14
Istog	5942	13.91
Kaçanik	245	0.58
Kamenicë	1510	3.53
Klinë	3645	8.57
Leposaviq	75	0.18
Lipjan	1580	3.69
Malishevë	586	1.37
Mitrovicë	627	1.46
Novobërdë	881	2.06
Obiliq	464	1.08
Pejë	3596	8.36
Podujevë	2182	5.29
Prishtinë	2392	5.59
Prizren	3589	8.45
Rahovec	615	1.44
Shtërpce	127	0.30
Shtime	250	0.58
Skenderaj	1780	4.16
Suharekë	1851	4.34
Viti	1729	4.01
Vushtrri	1768	4.11
Zubin Potok	332	0.78
Zveçan	105	0.25
Gjithsej të Paraqitura	42749	100.00

5.3 Njoftimi për Kërkesat

Njoftimi për kërkesat është punë e cila mbikëqyret nga Njësi i Informimit në bashkëpunim me stafin e Zyrave Regjionale. Dispozitat e legjislacionit në fuqi e trajtojnë dhe rregullojnë pjesëmarrjen e palëve dhe sigurojnë që procedurat përkatëse të procedimit të kërkesave dhe vendimmarrja mbi kërkesat të përmbushin standardet e kërkuara të procesit të rregullt dhe procedurave të paanshme, në këtë mënyrë duke siguruar që palët të cilat kanë interes ligjor në pronën e kërkuar të njoftohen për kërkesën dhe t'u ofrohet mundësia për të marrë pjesë në procedura. Kjo qasje është kryesorja gjatë procesit, duke ditur që për kërkesat vendoset bazuar në parashtrës me shkrim dhe zakonisht palët nuk kanë mundësi të prezantojnë dëshmi apo argumente gojore para KKPK-së.

Nga Sekretaria Ekzekutive kërkohet që të njoftojë dhe t'i dërgojë kopjen e kërkesës çdo personi të ndryshëm nga paraqitësi i kërkesës, i cili ushtron apo pretendon të drejtë në pronën e cila është lëndë e kërkesës, dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person i cili mund të ketë interes ligjor në pronë. Palët e njoftuara kanë të drejtë të përgjigjen në kërkesë dhe të paraqesin shkresat apo të prezantojnë dëshmitë në lidhje me kërkesën.

Palët njoftohen përmes vendosjes fizike të formularit të njohur si 'njoftimi për kërkesën' në pronën e kërkuar, ose përmes publikimit në gazetën e njoftimeve të AKP-së, i cili jep detajet e kërkesës dhe natyrën e të drejtës së kërkuar pronësore. Bashkë me njoftimin për kërkesën gjendet edhe njoftimi për pjesëmarrjen përmes të cilit njoftohen palët për të drejtën e tyre për të marrë pjesë në procedurë duke plotësuar këtë formular dhe duke e paraqitur atë në AKP brenda tridhjetë (30) ditësh apo përndryshe duke u paraqitur personalisht në zyrën e AKP-së për t'i dhënë këto informata.

Kur personi i cili ka interes ligjor në kërkesë nuk e ka marrë njoftimin për kërkesën, rregullat e procedurës parashohin që ai apo ajo mund të pranohet si palë në çdo fazë të procedurës, nëse kërkesa nuk është vendosur nga KKPK-ja.

5.4 Publikimi i Kërkesave

Publikimi i kërkesave është gjithashtu punë që e kryen Njësi i Informimit. Procedura e publikimit përfshinë

publikimin zyrtar të regjistrit me të gjitha kërkesat e paraqitura në AKP, në buletin e njohur si "Gazeta e AKP-së", e cila përmban adresën e pronës për të cilën është paraqitur kërkesa së bashku me numrin e kërkesës. Gazeta shpërndahet si shtojcë e një gazete në gjuhën shqipe në 10,000 kopje. Gazeta siguron që detajet e të gjitha pronave të kërkuara të arrijnë tek palët e interesuara dhe palët e mundshme përgjegjëse brenda dhe jashtë Kosovës. 5,000 kopje tjera në gjuhën shqipe dhe serbe në mënyrë të rregullt shpërndahen në të gjitha komunat, gjykatat, enklavat, organizatat për PZh-të dhe OJQ-të në tërë Kosovën. AKP-ja nuk mund të nxjerrë Gazetën e saj në Serbi dhe prandaj për të siguruar që informacioni shkon tek ata persona që duhet të jenë të informuar për ekzistimin e kërkesave, rreth 3.500 kopje të Gazetës së Zyrave Pronësore të UNHCR-së e cila përmban të njëjtat informacione si "Gazeta e AKP-së" është shpërndarë përmes Zyrave të UNHCR-it për Çështje Pronësore në Serbi. Gazeta gjithashtu publikohet edhe në ueb faqen e AKP-së.

Gjatë periudhës së raportimit 96 kërkesa të reja janë publikuar.

5.5 Qasja në të dhënat pronësore dhe përpunimi i kërkesave

Hulumtimi i plotë dhe verifikimi i të gjitha burimeve efikase të dëshmimeve dokumentuese mbi të drejtat pronësore është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e saktë të së drejtës pronësore. Kështu që, njëri ndër hapat e parë thelbësor të përfshirë në përpunimin e kërkesave përfshinë zyrtarët e Sekretarisë Ekzekutive që tentojnë të verifikojnë dokumentet e paraqitura në mbështetje të kërkesave, apo të bëjnë hulumtime *ex officio* në të dhënat pronësore publike në rastet kur paraqitësit e kërkesave nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentuese.

Deri më tani sa i përket qasjes në dokumentet brenda territorit të Kosovës, dispozitat e legjislacionit në fuqi parashohin që Sekretaria Ekzekutive dhe KKPK të kenë qasje të lirë dhe të hapur në të gjitha të dhënat publike në Kosovë, të cilat janë të rëndësishme për saktësinë e përpunimit dhe zgjidhjes së kërkesave. Si hap për të zbatuar këtë të fundit AKP dhe AKK kanë nënshkruar një MiM më 13 korrik 2009, ashtu që AKP-së i është dhënë qasje e lirë në të dhënat e AKK-së.

Qasja në të dhënat pronësore në Serbi është gjithashtu shumë e rëndësishme për verifikimin e kërkesave,

duke ditur që një pjesë e konsiderueshme e të dhënave pronësore nga Kosova gjenden atje. Pas mbylljes së zyrave të AKP-së në Serbi, edhe qasja e papenguar të cilën AKP-ja e gëzonte më herët në arkivat pronësore të zhvendosura atje ishte anuluar. Me hapjen e Zyrave të UNHCR-së për Çështje Pronësore në Serbi është rikthyer qasja në këto arkiva.

KKPK në asnjë mënyrë nuk është i kufizuar nga rekomandimet e Sekretarisë Ekzekutive në raportin e përpunimit të kërkesave. Përmes një apo më shumë anëtarëve të tij, ai bën shqyrtim të pavarur të dëshmimeve dokumentuese. Merr vendim përfundimtar për secilën kërkesë, pas shqyrtimit të rekomandimeve nga raporti dhe bazuar në vlerësimin e vet të pavarur të çështjeve.

Zyra e KKPK-së përbëhet nga personeli juridik, administrativ dhe gjuhësor, dhe i cili i ofron KKPK-së përkrahje juridike, administrative dhe logjistike. Zyra e KKPK-së vepron nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komisionit dhe mban kontakte me Komisionerët, bën kontrollin e kualitetit të kërkesave të paraqitura Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive para seancave të Komisionit, bën hulumtime ligjore, i përgatit draft-vendimet për nënshkrim nga Kryetari i Komisionit. Përgatitja e vendimeve të individualizuara për paraqitësit e kërkesave, palët përgjegjëse dhe palët tjera në bazë të vendimeve grupore, gjithashtu bëhet nga Zyra e KKPK-së.

5.6. Vendosja e kërkesave nga Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK)

Komisioni ka mbajtur gjashtë seanca gjatë periudhës së raportimit, duke vendosur mbi 2,604 kërkesa prej të cilave 2,381 kërkesa të reja dhe 223 kërkesa të shfuqizuara më parë. 972 kërkesa të reja janë kontestuar nga uzurpuesit/palët përgjegjëse të cilët janë paraqitur në zyrën e AKP-së pasi që prona ishte notifikuar dhe publikuar.

Konfirmimi i të drejtës pronësore nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për t'iu kthyer posedimin e pronës paraqitësve të suksesshëm të kërkesave kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme. KKPK-ja kur e konfirmon të drejtën pronësore mund të urdhërojë gjithashtu riposedimin e pronës në favor të paraqitësit të kërkesës dhe të japë edhe urdhra tjerë pasues nëse e sheh të nevojshme për t'ia mundësuar bartësit të së drejtës pronësore të ushtrojë të drejtën e

tij/saj pronësore. Prandaj, KKPK-së në mënyrë të qartë i janë dhënë kompetencat për të siguruar pajtueshmëri me detyrimet ligjore të vendimeve në favor të bartësve të së drejtës pronësore/pronarëve.

Kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh faktin që edhe nëse kërkesa është e pakontestuar, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që prona nuk shfrytëzohet apo nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme; mund të jetë edhe kjo, por edhe kur uzurpuesi nuk dëshiron të marrë pjesë, për çfarëdo arsye, në procedurë. Më tej, në rastet kur prona e kërkuar nuk duket se është e uzurpuar në kohën e notifikimit, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që prona më herët nuk ka qenë e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, apo nuk do të uzurpohet në mënyrë të paligjshme në të ardhmen. Kështu që, në rastet kur prona është e pakontestuar në ditën e lëshimit të vendimit, urdhri i Komisionit i cili konfirmon të drejtën dhe urdhëron riposedimin që përfshin edhe dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm, mbron të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës në skenarë të tillë të mundshëm.

Si rezultat i mosbesimit ndëretnik i cili mbizotëron në Kosovë, shumë minoriteteve iu mungon besimi në institucionet publike. Në këto rrethana, vendimi i KKPK-së, edhe kur prona nuk është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, konsiderohet nga bartësit e të drejtës pronësore si siguri për interesat e tyre në pronë, që të ballafaqohen me ndonjë pasiguri të cilën do ta zbulonin dhe e cila do t'i dëmtonte sa i përket ndërrhyrjeve në të dhënat publike pronësore. Gjithashtu, duke ditur që shumë paraqitës të kërkesave nuk mund të kenë qasje në pronat e tyre, vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës ka funksion të rëndësishëm pasi që sqaron dhe konfirmon situatën mbizotëruese aktuale ligjore, në veçanti në rrethanat ku paraqitësit e kërkesës mund të kenë humbur dokumentet e tyre të pronësore, apo kur ato u janë shkatërruar në rrethanat e krijuara nga konflikti.

5.7 Statistikat për Kërkesat e Vendosura

2,577 kërkesa të vendosura nga KKPK hyjnë në kategoritë në vijim:

Kategoria e Kërkesave	Numri i Kërkesave të reja të vendosura	Numri i kërkesave të rivendosura
Tokë bujqësore	1,485	196
Pronë komerciale	279	13
Pronë banesore	624	39
Gjithsejtë	2,361	248

KKPK mund të miratojë, refuzojë apo hedh poshtë kërkesën apo të lëshojë ndonjë vendim apo urdhër i cili është i nevojshëm për ta zbatuar ligjin në fuqi, përfshirë urdhrat për kthimin e të drejtave pronësore dhe riposelimin e pronës.

Vendimet e KKPK-së janë ligjërisht detyruese, pa cenuar të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës, si parashihet me legjislacionin në fuqi, i cili parasheh gjithashtu llojin e urdhrave që KKPK-së i lejohet t'i lëshojë.

Sipas legjislacionit në fuqi kërkohet që vendimet e KKPK-së të përmbajnë arsyetimin dhe të jenë me shkrim, duke cekur faktet materiale dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga KKPK-ja. Deri më tani, sa i përket marrjes së vendimeve, legjislacioni në fuqi parasheh që vendimet të merren në mënyrë unanime, por kur nuk mund të arrihet konsensus, kërkesa mund të vendoset me shumicë votash. Përveç kësaj, me qëllim që të lejohet zgjidhja e shpejt e kërkesave, KKPK-ja përdorë metodat të cilat i lejojnë të lëshojë një vendim për pakot me kërkesat nga të cilat rrjedhin çështje të ngjashme ligjore, i njohur si “Vendim Grupor”.

Kryetari duke nënshkruar Vendimin Grupor aprovon të gjitha vendimet individuale të identifikuara dhe regjistruara me numër të kërkesës në Vendimin Grupor. Gjatë periudhës së raportimit, KKPK-ja ka lëshuar 39 vendime grupore, duke përfshirë 2,381 kërkesa të reja dhe 196 kërkesa të shfuqizuara më parë.

Kur kërkesa të jetë vendosur me vendim grupor, që të jetë e qartë për palët, përgatitet vendimi individual për secilën kërkesë i cili thekson detajet e pronës individuale të paraqitësit të kërkesës dhe ndihmën ligjore të miratuar nga KKPK-ja. Vendimi individual i referohet vendimit grupor të KKPK-së dhe paragrafit të veçantë i cili thekson arsyet për vendimin sa i përket kërkesës.

Vendimet e KKPK-së gjenden të publikuara në ueb faqen e AKP-së.

5.8 Zbatimi

Sipas legjislacionit në fuqi, zbatimi efikas i vendimeve përfundimtare për kërkesat arrihet përmes masave që përfshijnë por nuk janë të kufizuara, në vendosjen e pronës nën administrimin e AKP-së, dëbimin, sekuestrimin dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme, ankandet dhe marrëveshjet për qiranë. Zbatimi i vendimeve të KKPK-së është punë e Sekretarisë Ekzekutive e cila kryhet nga Njësiti i Implementimit. Aktivitetet e zbatimit që përfshijnë dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm i kryen Njësiti i Dëbimeve të AKP-së.

a. Shpërndarja e Vendimeve të KKPK-së

Procedura e shpërndarjes së vendimeve të KKPK-së si hap i parë në procesin e zbatimit përfshin Qendrën e Thirrjeve të AKP-së e cila i kontakton me telefon palët në kërkesë për t'i informuar se vendimi është lëshuar dhe mund të merret, si dhe cakton takimin me ta për t'iu dorëzuar vendimet në Zyrën e AKP-së apo në Zyrat për Çështje Pronësore të UNHCR-së (aty ku është e mundshme) sipas preferencës së paraqitësit të kërkesës. Pas dorëzimit të vendimit, ka një afat prej 30 ditësh për ankesë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive. Përveç kësaj, ky takim ofron mundësi për t'i informuar paraqitësit e kërkesave me procesin e implementimit dhe për t'i njoftuar paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nëse dhe si do të donin të zbatohej vendimi. Gjatë periudhës së raportimit, AKP-ja ka shpërndarë 5,985 vendime dhe 1001 vendime u janë shpërndarë palëve përgjegjëse apo uzurpuesve aktualë. 4,071 vendime u janë dërguar paraqitësve të kërkesave personalisht, 905 vendime që nuk janë marrë janë publikuar në Zyrat Regjionale, dhe 8 vendime tjera janë shpërndarë përmes ueb faqes së AKP-së.

Më 23 dhjetor 2014, AKP ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Joqeveritare “Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë” (SHPRK) për bashkëpunim. Qëllimi i këtij Memorandumi Bashkëpunimi është transporti dhe shpërndarja e dokumenteve që ndërlidhen me rastet e paraqitura në AKP në destinacion: Zyra Qendrore e AKP-së tek Zyrat e SHPRK-së në Podgoricë dhe anasjelltas. Po ashtu, si pjesë e këtij Memorandumi do të jetë edhe ofrimi i shpjegimeve të nevojshme që të do të ofrojnë SHPRK, në lidhje me procedurat e zbatimit të vendimeve të pranuar të AKP-së, si dhe dokumentet tjera

me rëndësi për të gjithë parashtruesit e kërkesave që aktualisht jetojnë në Mal të Zi.

Po ashtu, ky Memorandumi merr përsipër që procesi i transportit dhe shpërndarja e dokumenteve relevante të AKP-së në Mal të Zi, të realizohet çdo dy javë, prandaj kjo do të jetë një lehtësi edhe për parashtruesit e kërkesave që jo vetëm të pranojnë dokumentet zyrtare të AKP-së por të kontaktojnë edhe fizikisht personat e autorizuar të SHPRK-së. Ky Memorandum bashkëpunimi e lehtëson punën e AKP-së në procesin e zbatimit të vendimeve të marra nga KKPK.

AKP-ja ka pranuar 1,712 kërkesa për vënien e pronës nën administrim, 420 kërkesa për riposedit dhe 363 kërkesa për mbyllje të rastit nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Janë përpunuar 1,283 kërkesa për administrim dhe janë dërguar në Njësitin për Administrimin e Pronave. Janë përpunuar 206 raste për riposedit të pronës, 299 kërkesa janë dërguar për mbyllje me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, 2,341 kërkesa janë hedhur poshtë/refuzuar dhe nuk është bërë asnjë ankesë për mbylljen e rastit. Paraqitësit e kërkesave kanë parashtruar 70 kërkesa për tërheqje dhe 4,955 kërkesa tjera janë dërguar për mbyllje për shkak të mosbashkëpunimit. Numri i përgjithshëm i vendimeve të zbatuara të KKPK-së gjatë periudhës së raportimit është 9,357.

b. Shpërndarja dhe zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës për ankesat kundër vendimeve të KKPK-së

Sipas legjislacionit në fuqi, ankesat kundër vendimeve të KKPK-së paraqiten në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive e cila është gjithashtu përgjegjëse për shpërndarjen dhe zbatimin e aktgjykimeve. Procedurat dhe formati që përdoret për paraqitjen e ankesave është bërë në marrëveshje me Panelin e Ankesave të Gjykatës Supreme. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme dërgohen në AKP dhe Sekretaria Ekzekutive iu shpërndan vendimet palëve. Shpërndarja e aktgjykimeve të Gjykatës Supreme dhe njoftimi për mbledhjen e tarifave gjyqësore ndjek të njëjtën procedurë si njoftimi për vendimet e KKPK-së siç është përshkruar në pjesën më lart. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme janë të formës së prerë dhe të zbatueshme dhe nuk mund të kundërshtohen përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme ligjore; dhe bëhen të ekzekutueshme pesëmbëdhjetë ditë pasi të bëhet njoftimi i palëve.

Gjatë periudhës raportuese, AKP-ja ka pranuar 353 ankesa kundër vendimeve të KKPK-së. Prej tyre, 327 i kanë plotësuar kriteret e ankesës dhe si rezultat 103 (përfshirë disa ankesa të pranuar në vitin 2013) janë dërguar në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme ka vendosur 183 ankesa, 122 prej të cilave janë refuzuar kurse 61 janë miratuar. Prej tyre, 183 aktgjykime të Gjykatës Supreme u janë dërguar paraqitësve fillestarë të kërkesave, 87 palëve përgjegjëse fillestare dhe 38 palëve të interesuara.

c. Zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

AKP-ja ka gjithashtu mandat sipas legjislacionit në fuqi të zbatojë kërkesat pronësore banesore të cilat kanë qenë në pritje më 4 mars 2006, dhe të menaxhojë dosjet e pronave të administruara nga DÇPB-ja. Për të ushtruar këtë aspekt të mandatit të saj, AKP-së i janë dhënë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e DÇPB-së.

Përveç kësaj, ka pasur një numër kërkesash të paraqitura në DÇPB dhe të vendosura nga KKPB-ja ku paraqitësit e suksesshëm të kërkesave nuk kanë kërkuar zbatimin e vendimeve në atë kohë, dhe DÇPB-ja i kishte mbyllur këto raste pa zbatimin fizik. Si pasojë, AKP-ja ka pranuar gjatë vitit 2014, gjithsej 7 kërkesa për riposedit të paraqitura nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave. Duke pasur parasysh se paraqitësit e kërkesave në të gjitha këto kërkesa kanë pasur të drejtë për dëbim sipas vendimit të KKPB-së, të gjitha këto kërkesa janë miratuar. Në 2 raste, prona u është kthyer në riposedit paraqitësve e kërkesave kurse për 5 rastet e mbetura, procedura është duke vazhduar dhe vendimi i KKPB-së do të zbatohet në kohën e duhur.

d. Kërkesat nga Zyrat Kadastrale Komunale

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e kërkesave nga zyrat kadastrale komunale për verifikim nëse janë paraqitur kërkesa pronësore në AKP/DÇPB për pronën përkatëse. Nga zyrat kadastrale komunale kërkohet që të paraqesin kërkesa të tilla me rastin e regjistrimit të pronave të reja në pajtim me nenin 1, par. 3.3.c i Ligjit nr. 2003/13 për Ndryshimet në Ligjin nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave në Pronën e Pajtuajtshme.

Nr.	Emri i Institucionit	Numri i Kërkesave për regjistrim të Pronës në Kadastër
1	Komuna e Prishtinës	907
2	Komuna e Mitrovicës	22
3	Komuna e Gjilanit	48
4	Komuna e Kamenicës	0
5	Komuna e Pejës	67
6	Komuna e Obiliqit	25
7	Komuna e Hanit te Elezit	3
8	Komuna e Fushe Kosovës	3
9	Komuna e Vushtrrisë	23
10	Komuna e Vitisë	2
11	Komuna e Suharekës	1
		Numri total i kërkesave për këtë periudhë - 1, 101
	27	Numri i përgjithshëm që nga viti 2012 2,780

e. Kërkesat nga Agjencia Kadastrale e Kosovës

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e kërkesave nga ZKK për verifikim nëse janë paraqitur kërkesa pronësore në AKP/DÇPB për pronën përkatëse. Nga ZKK kërkohet që të paraqes kërkesa të tilla me rastin e regjistrimit të pronave të reja në pajtim me nenin 1, par. 3.3.c i Ligjit nr. 2003/13 për Ndryshimet në Ligjin nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave në Pronën e Paluajtshme.

	Komunat:	Numri i Kërkesave të pranuar	Numri i kërkesave të identifikuar
1	Deçan	78 kërkesa	23 HPD
2	Dragash	80 kërkesa	5 HPD
3	Hani I Elezit	34 kërkesa	0 HPD
4	Kamenicë	171 kërkesa	Në proces
5	Istog	229 kërkesa	21 HPD +4 KPA = 25
6	Mitrovicë Veri	14 kërkesa	8 HPD
7	Mitrovicë Jug	637 kërkesa	Në proces
8	Shtërpçë	20 kërkesa	1 HPD -1 KPA = 2
9	Novobrd	4 kërkesa	3 HPD
10	Kaçanik	102 kërkesa	8 HPD + 1 KPA = 9
11	Skënderaj	530 kërkesa	Në proces
12	Graçanicë	39	Në proces
		Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për periudhën e raportimit: – 1.938	Numri i përgjithshëm i kërkesave të identifikuar për këtë periudhë
		Total i i përgjithshëm që nga viti 2012 – 15.411	69 HPD + 6 KPA = 75 kërkesa

f. Kërkesat e pranuar nga institucionet tjera

Kërkesat e pranuar nga institucionet e ndryshme publike dhe organe të tjera qeveritare për verifikim të kërkesave lidhur me privatizimin e banesave sipas nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-061, për Shitjen e Banës.

Nr.	Emri i Institucioneve	Numri i kërkesave për privatizim të banesave 2014
1	Korporata Energjetike e Kosovës	3
2	Agjencia Kosovare e Privatizimit	226
3	Ministria e Punëve të Brendshme	37
4	Ministria e Shëndetësisë	0
5	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	5
6	Universiteti i Prishtinës	25
7	Ndërmarrja Hidroekonimike IBËR-LEPENC	0
8	Kompania Ujësjetllësi Rajonal "Prishtina "	0
9	Komuna e Mitrovicës	16
10	Komuna e Prishtinës	118
11	Komuna e Suharekës	13
12	Komuna e Podujevës	28
13	Komuna e Gjilanit	16
14	Komuna e Lipjanit	5
15	Komuna e Vushtrris	3
16	Komuna e Prizrenit	1
17	PTK	36
18	Kompania Rajonale e Mbeturinave "PASTRIMI"	0
19	Komuna e Ferizajt	19
20	Zyra e Kryeministrit	19
21	Komuna e Skenderajt	0
22	Komuna e Fushe Kosovës	0
23	Komuna e Klines	0
24	Operator sistemi, transmissiioni dhe tregu sh.a Kostt	1
25	Komuna e Glogocit	7
26	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	0
27	Komuna e Dragashit	10
28	Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës	0
29	Ndërmarrja Publike Banesore	0
30	Komuna e Hanit të Elezit	3
31	Komuna e Vitisë	0
32	Komuna e Kaçanikut	0
33	Komuna e Pejës	1
34	Komuna e Deçanit	0
35	Komuna e Istogut	0
36	Trafiku Urban	1
37	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	2
38	Ministria e Infrastrukturës	1
39	Infrakos	42
40	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	3
41	CF "PRISHTINA" sh.p.k	1
42	Komuna e Kamenicës	2
		Numri i përgjithshëm për këtë periudhë raportuese 644
		Gjithsej që nga viti 2012 - 2.228

g. Kërkesa të pranuar nga Gjykatat Themelore të Kosovës

Kërkesat e pranuar nga Gjykatat Themelore të Kosovës për verifikim, nëse dikush ka të parashtruar kërkesë pranë AKP/DÇPB për pronat që janë objekt i procedurave pranë gjykatave përkatëse.

Nr.	Gjykatat e Kosovës	Numri i Kërkesave
1	Gjykata Themelore e Prishtinës	44
2	Gjykata Themelore e Prizrenit - Dega Suhareke	8
3	Gjykata Themelore e Mitrovicës - Dega Skenderaj	7
4	Gjykata Themelore e Prishtinës - Dega Podujeve	1
5	Gjykata Themelore e Pejës	8
6	Gjykata Themelore e Mitrovicës	2
7	Gjykata Themelore e Gjilanit - Dega Viti	33
8	Gjykata Themelore e Gjilanit - Dega Kamenice	4
9	Gjykata Themelore e Prizrenit	1
10	Gjykata Themelore e Ferizajt	1
		Numri i përgjithshëm për këtë periudhë raportuese: 109
		Gjithsej: 165

5.9. Zbatimi i Skemës së Kompensimit

AKP si pasardhëse e përgjegjëse të DÇPB, është përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e skemës së kompensimit lidhur me pronat shoqërore banesore ku KKPb ka konstatuar se diskriminimi kishte ndikuar që bartësit fillestar të së drejtës pronësore t'i mohohet mundësia e blerjes së pronës banesore në fjalë, e cila rrjedhimisht i ishte caktuar dhe ishte blerë nga palë tjetër.

Neni 19 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079 thekson:

“Agjencia Kosovare e Pronës i merr përsipër përgjegjësitë e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK 2000/60 mbi kthimin e të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit. Dispozitat e saj do t'i zbatojë në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e shumave të përmendura në nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 “.

Bordi Mbikëqyrës i AKP-së ka miratuar kriteret dhe procedurat në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2011 dhe puna e mëvonshme është bërë në lidhje me përcaktimin e kostos së saktë të skemës dhe mënyrën se si do të financohet skema. Përveç kësaj, Ministria e Financave ka krijuar një Fond Besimi për skemën. AKP-ja iu ka dërguar një letër të gjithë donatorëve që të ofrojnë një propozim për financimin e skemës. Megjithatë nuk janë pranuar përgjigje pozitive prandaj çështja i është drejtuar Qeverisë së Kosovës për të kërkuar fondet e nevojshme për implementimin e skemës. Janë mbajtur disa takime dhe konsultime të mëtejshme janë planifikuar me qëllim avancimin e çështjes.

5.10. Mbyllja e Kërkesave

Pas zbatimit të një kërkesë të vendosur, ajo kërkesë duhet të mbyllet dhe ky veprim ndërmerret nga Njësia e Mbylljes së Kërkesave. Objektivi e fazës së mbylljes është të sigurojë që mekanizmi i AKP-së është respektuar në të gjitha fazat e procesit, veçanërisht në lidhje me afatet dhe procesin e rregullt, duke adresuar ku është e nevojshme dhe e mundshme gabime sipas nevojës dhe, më tej, të mbyllet kërkesa pas vlerësimit që rregullat dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe Procedurat Standarde Operative janë respektuar.

Gjatë vitit 2014 janë mbyllur gjithsej 7,671 kërkesa:

4,635 kërkesa nga kategoria “Mosbashkëpunim – Paraqitësit e kërkesave janë njoftuar për vendimet”;
895 kërkesa të zbatuara duke marrë pronat nën administrim;
200 kërkesa të zbatuara me mbyllje pa zbatim;
991 kërkesa të mbyllura meqë janë hedhur poshtë nga KKPb;
54 kërkesa të zbatuara me riposëdim pa dëbim;
264 kërkesa të zbatuara me mohim të kërkesës për administrim;
29 kërkesa të zbatuara me riposëdim me dëbim;
23 kërkesa të mbyllura meqë janë hedhur poshtë nga Sekretaria Ekzekutive;
38 kërkesa të mbyllura meqë janë tërhequr nga paraqitësi i kërkesës;
369 kërkesa të mbyllura meqë janë refuzuar nga KKPb; dhe
173 kërkesa nga kategoria “Mosbashkëpunim – Paraqitësi i Kërkesës nuk ka marrë vendimin final”.

5.11 Ndërmjetësimi

Në bazë të nenit 15 të Rregullores nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale dhe në mënyrë që të përpiqen për të zbatuar vendimin e KKKP-së pa përdorur atë për shkatërrim të ndërtesës/ave AKP-ja ka filluar të bëjë ndërmjetësim mes bartësve të të drejtave pronësore dhe ata të cilët ose kanë fituar token me mirëbesim dhe kanë ndërtuar mbi të ose kanë blerë pronën e ndërtuar në tokë mbi të cilën ndërtuesi nuk ka pasur të drejtë pronësie.

Në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi AKP-ja ka krijuar kornizën ligjore që rregullon ndërmjetësimin, “Procedura për Ndërmjetësim të Brendshëm”, e cila është në fuqi që nga 17 tetori 2013 dhe është duke u aplikuar nga ndërmjetësuesit e AKP-së. AKP ka identifikuar dhe vazhduar me ndërmjetësim në 28 raste. Për disa nga këto raste KKKP ka rekomanduar këtë proces, në raste të tjera në lidhje me ndërmjetësimin është vendosur nga Sekretaria Ekzekutive.

Nga stafi i Agjencisë, janë 31 ndërmjetësues dhe që të gjithë e kanë kryer trajnimin për ndërmjetësues të mbështetur nga Qeveria Britanike. Për rastet për të cilat ka filluar ndërmjetësimi janë 26 ndërmjetës të emëruar në lidhje me 13 raste, që përfshijnë 13 bartës të të drejtave pronësore dhe 18 palë përgjegjëse. Dy ndërmjetësues janë caktuar për një rast, një nga rajoni ku gjendet prona dhe një është nga Zyra Rajonale që është më e afërt me vendbanimin e parashtruesit të kërkesës. Aktualisht, janë të përfshira zyrat rajonale të Prishtinës, Pejës, Prizrenit dhe Gjilanit. 15 rastet e mbetura janë në pritje për shkatërrim, pasi që AKP-së t’i ofrohen fondet nga Qeveria dhe partnerët.

5.12 Administrimi i Pronës, Skema vullnetare e qirasë dhe aktivitetet e dëbimit

a. Administrimi i Pronës

Me Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 DÇPB-ja u autorizua që të vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm. Në mars të vitit 2006, AKP-ja duke marrë përgjegjësinë për operacionet e DÇPB-së mori përgjegjësinë për menaxhimin e

pronave që tashmë ishin nën administrim të DÇPB-së, si dhe për vazhdimin e zbatimit të skemës.

Neni 23.1 i Shtojcës I të legjislacionit në fuqi e autorizon AKP-në të administrojë pronat në secilën nga këto rrethana:

- Me marrëveshje në mes të palëve për zgjidhjen e kërkesës së paraqitur në AKP;
- Me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, pas vendimit përfundimtar i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit të kërkesës;
- Nëse nuk është paraqitur kërkesë për administrim të pronës, pas zbatimit të vendimit të
- Komisioni, dhe dëbimit të banuesit aktual, nëse bartësi i së drejtës pronësore dështon që pronën ta kthejë në riposedim pas njoftimit për ekzekutimin e dëbimit.

Punët dhe detyrat lidhur me Administrimin e Pronave kryhen nga Njësi i Administrimit të Pronave i AKP-së.

Gjatë periudhës së raportimit rreth 1,127 prona të reja janë marrë nën administrim të AKP-së, nga të cilat 929 ishin prona bujqësore, 11 ishin prona komerciale dhe 187 prona banesore. 310 kërkesa për administrim janë mohuar për shkak të disa përjashtimeve, të tilla si pyje, të cilat nuk mund të merren nën administrim. Gjatë kohës së raportimit kanë qenë 12,919 prona nën administrim të AKP-së edhe pse në afro 328 raste bartësi i së drejtës pronësore/pronari ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e administrimit.

Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ka dorëzuar 15 prona të cilat ishin marrë ex officio nën administrim. 314 prona mbesin dhe AKP-ja vazhdon me strategjinë e zbatimit në prill të vitit 2009 për të identifikuar bartësit e së drejtës pronësore dhe për t’iu mundësuar atyre marrjen nën kontroll të pronave.

b. Skema e Qiradhënies Vullnetare

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh që skema e qiradhënies të zbatohet për pronat që janë nën administrim, ku parat e mbledhura nga qiraja për pronën nën administrim do të vireshin në një llogari të posaçme mirëbesimi për pronarin e ligjshëm. Një skemë e tillë e qirasë ishte propozuar gjatë kohës së funksionimit të DÇPB-së, por për shkak të natyrës së ndjeshme politike të kësaj çështjeje, AKP-ja mori aprovimin e nevojshëm politik tek në gusht të

vitit 2006 dhe u bë e zbatueshme në tetor të vitit 2006.

Skema e qiradhënies vullnetare ofron burim të të ardhurave minimale nga pronat për bartësit e së drejtës pronësore/pronarët, të cilët përndryshe mund të vendosin t'i shesin pronat e tyre.

Me një vlerësim të favorshëm të kushteve dhe të përshatshmërisë së pronës për përfshirje në skemën e qiradhënies vullnetare dhe me pajtimin e bartësit të së drejtës pronësore/pronarët e pronave, AKP-ja do të provojë që të lëshojë me qira pronën përmes një marrëveshjeje me palën e tretë. Nëse lokalet nuk lëshohen me qira nuk do të ketë pagesë të qirasë, por nëse pala e tretë pajtohet që ta marrë me qira pronën, atëherë AKP-ja e mbledh qiranë në baza mujore për pronat banesore dhe komerciale ndërsa për pronat bujqësore mbledh qiranë në baza vjetore dhe ia dorëzon atë bartësit të së drejtës pronësore minus 5% për shpenzime administrative. Në rastet se qiraja nuk paguhet, AKP-ja mund dhe do ta dëbojë uzurpuesin. AKP-ja merr depozitë për pronat banesore dhe komerciale nga qiramarrësi për të mbuluar ndonjë qira të paguar ose ndonjë dëmtim të pronës nëse qiramarrësi është përgjegjës për këtë dëmtim. Pjesa e mbetur e depozitës do t'i kthehet qiramarrësit pas përfundimit të marrëveshjes dhe pas inspektimit të pronës.

Në kohën e raportimit 1,167 qiramarrës kanë nënshkruar marrëveshjen e qirasë, prej të cilave 245 janë për prona bujqësore, 5 janë për pronë komerciale dhe 917 për prona banesore.

Gjatë periudhës së raportimit, 1,482 prona të reja janë përfshirë në skemën vullnetare të qirasë, prej të cilave 335 ishin prona bujqësore, 8 prona komerciale dhe 1,139 prona banesore. Deri në fund të periudhës së raportimit, gjithsej 4,527 prona janë përfshirë në skemën vullnetare të qirasë. Nga numri i përgjithshëm i pronave nën administrimin e AKP-së, 2,523 prona janë identifikuar si të papërshtatshme për t'i përfshirë në skemë për shkak të lokacionit të tyre ose për shkak të kushteve të këqija.

Gjatë periudhës së raportimit shuma prej 570,131.93€ është mbledhur nga qiraja; 465,818.28€ u janë transferuar pronarëve të identifikuar; 46,721.05€ mbahen si depozitë për pronarët e paidentifikuar dhe 25,485.43 mbahen si depozita të sigurisë. Shuma prej 23,139.23€ është rezervuar për shpenzime administrative të zbatimit të skemës.

Banori i cili nuk pajtohet të paguajë qiranë ose nuk e paguan më qiranë ka 30 ditë afat për të lëshuar pronën. AKP-ja e zbaton dëbimin pasi të ketë kaluar afati prej 30 ditësh, nëse banori nuk e ka liruar pronën vullnetarisht. Pas lirimit të pronës ajo mund t'i lëshohet me qira ndonjë qiramarrësi tjetër. Kur prona nuk është e dëmtuar, qiramarrësit të dëbuar i kthehet depozita e tij/saj.

c. *Aktivitetet e Dëbimit*

Më 29 shtator 2011, u nënshkrua versioni i rishikuar i MiM me Policinë e Kosovës për të mbështetur AKP-në në dëbime. Ky version i rishikuar formalizoi një procedurë të re të zbatuar nga AKP-ja ashtu që personeli rajonal i AKP-të të ndërmarr dëbimin fillestar pa mbështetjen e policisë. Dëbimi fillestar përfshinë njoftimin për vërejtjen e fundit, me të cilin njoftohen uzurpuesit se në rast të ri-posedimit ata duhet ta lirojnë pronën apo në rast se nuk e paguajnë qiranë ata duhet të paguajnë shumën e qirasë të detyrueshme sipas kontratës së qirasë apo ta lirojnë pronën brenda afatit të dhënë. Në datën kur skadon afati, personeli rajonal kthehet në pronë për të kryer dëbimin apo në rast se prona lirohet vullnetarisht, për të siguruar pronën. Në rast se uzurpuesi refuzon të lirojë pronën atëherë planifikohet dëbimi me mbështetjen e policisë. Pas planifikimit të këtyre dëbimeve, ato nuk mund të anulohen përveç në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm me miratimin e Drejtorit apo Zv/Drejtorit Ekzekutiv të AKP-së.

Gjatë vitit 2014, Njësia e Dëbimit e AKP-së ka planifikuar 2.384 dëbime. Nga këto, 836 dëbime fizike janë ndërmarrë nga Njësia e Dëbimit me mbështetjen e Policisë së Kosovës, 117 ishin për riposeditim, 402 për uzurpim të paligjshëm, 75 për mospagesë të qirasë dhe 241 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë dhe 1 lëndë e ri-hapur. 1,349 dëbime janë anuluar për shkak të pagesës së borxhit të qirasë pas paralajmërimit përfundimtar të lëshuar si pjesë e dëbimit fillestar nga Zyrrat Regionale. Për arsye të tjera nga pagesa, AKP ka anuluar 283 dëbime. Në fund të vitit, Njësiti i Dëbimeve ka pasur 669 dëbime në pritje për t'u planifikuar me mbështetjen e Policisë së Kosovës.

Procesi i dëbimit i mbështetur nga Policia e Kosovës në veri të Mitrovicës rifilloi në shtator të vitit 2009, megjithatë u ndërpre pas një incidenti në janar 2010. Për të siguruar vazhdimësinë e funksionimit në veri të Mitrovicës, AKP-ja vendosi që të vazhdojë me dëbimet pa mbështetjen e policisë, pasi që këto ishin më pak të

kundërshtueshme, meqë shumica e rasteve janë përfunduar me dialog. Megjithatë, kjo nuk ishte një situatë e qëndrueshme. Janë kryer disa dëbime në veri të Mitrovicës gjatë gjysmës së parë të vitit 2011 në rastet më të rënda me mbështetjen e EULEX-të. Procesi i dëbimeve më parë ishte penguar dukshëm për shkak të situatës politike dhe tensionit në popullatën lokale. Si rezultat i kësaj që nga gushti 2011 deri në mars 2014 nuk është ekzekutuar asnjë dëbim. Nga marsi 2014, dëbimet në veri të Mitrovicës kanë filluar pas negociatave të gjata me Policinë e Kosovës.

Numri i përgjithshëm i dëbimeve në pritje përfshirë edhe ato me ndihmën e Policisë së Kosovës deri në fund të dhjetorit 2013 arriti në 655 dhe është paraqitur më poshtë si vijon:

Mitrovica Jugore: 152 dëbime në pritje - 9 për riposëdim, 11 për uzurpim të paligjshëm, 44 për mospagesë të qirasë dhe 88 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë.

Mitrovica Veriore: 301 dëbime në pritje - 27 për riposëdim, 3 për uzurpim të paligjshëm, 136 për mospagesë të qirasë dhe 135 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Pejë: 134 dëbime në pritje - 14 për riposëdim, 31 për uzurpim të paligjshëm, dhe 87 për mospagesë të qirasë dhe 2 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë.

Prishtinë: 38 dëbime në pritje - 19 për riposëdim, 7 për uzurpim të paligjshëm, dhe 9 për mospagesë të qirasë dhe 3 për refuzim për të hyrë në marrëveshje të qirasë.

Prizren: 27 dëbime në pritje - 5 për riposëdim, 7 për uzurpim të paligjshëm, 7 për shkak të mospagesës së qirasë dhe 8 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Gjilan: 17 dëbime në pritje - 8 për riposëdim, 2 për uzurpim të paligjshëm, 6 për mospagesë të qirasë dhe 1 për refuzim për të hyrë në marrëveshje me qira.

Bazuar në numrat e dhënë më sipër, mund të shihet se Rajoni i Mitrovicës është rajoni i cili është më së paku në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Mbështetja e të gjitha palëve, duke përfshirë publikun është e nevojshme për të adresuar

këtë çështje. AKP-ja ka adresuar këtë çështje me disa organizata ndërkombëtare si zgjidhje ideale të çështjes sipas pikëpamjeve të AKP-së do të ishte që të gjithë personat të cilët në mënyrë të paligjshme kanë zënë një pronë, ta rregullojnë atë uzurpim duke paguar qiranë e kërkuar, pasi kjo do t'i sigurojë bartësit të së drejtës pronësore të ardhura në vend të posedimit të pronës së tij, gjithashtu duke siguruar banuesin se ata nuk do të dëbohen nga prona pa marrë në konsideratë kushtet e marrëveshjes së qirasë, si dhe t'i lejojë AKP-së të përqendrohet në ato raste ku dëbimi është i pashmangshëm kur bartësi i së drejtës pronësore kërkon ri-posëdimin e pronës.

d. Rastet e ri-uzurpimit serik

Siç mund të shihet më lart, AKP-ja kryen lloje të ndryshme të dëbimeve.

Në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka kërkuar ri-posëdim të pronës, AKP e ndërmerr dëbimin në kohën e caktuar me paraqitësin e suksesshëm të kërkesës dhe përveç kësaj kërkon që paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës të marrë pjesë në dëbim. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës nuk merr pjesë në dëbim, ata i kanë 3 ditë afat për ta informuar AKP-në me dëshmi përkatëse që prona është ri-uzurpuar. Në këto raste AKP-ja e merr pronën nën administrim dhe e kryen një dëbim të dytë në kohën e caktuar me paraqitësin e suksesshëm të kërkesës në mënyrë që paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi i tij/saj të marrë pjesë në dëbim. Në rast të dëbimit të dytë, AKP-ja e mbyll rastin dhe çdo ri-uzurpim i pronës duhet të paraqitet nga paraqitësi i kërkesës tek autoritetet lokale.

Në rastet kur prona është nën administrimin e AKP-së, e përfshirë apo jo në Skemën e qiradhënies Vullnetare, AKP-ja kryen dëbimin kur prona është uzurpuar në mënyrë të paligjshme, kur uzurpuesit i është ofruar pakoja e qirasë por ai/ajo refuzon ta paguajë qiranë, dhe kur një person ndërpret pagesën e qirasë. Është vërejtur që në shumicën nga këto raste, i njëjti person/familje që dëbohet nga prona, e ri-uzurpon menjëherë atë. Në shumë raste numri i ri-uzurpimeve dhe dëbimeve ka kaluar numrin dhjetë për personin dhe pronën e njëjtë. Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme dhe thyerja e drynit zyrtar është vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës dhe AKP-ja i paraqet këto raste në gjykatë kur ato ndodhin si dhe ka kërkuar

mbështetjen e EULEX-it që këto raste të shqyrtohen në Prokurori dhe në Gjykata. Megjithatë, kjo nuk ka qenë efektive sa është prituri dhe nuk e ka pasur efektin e parandalimit që është kërkuar. Për të adresuar këtë, u arrit një marrëveshje më 23 gusht 2012 me Policinë e Kosovës dhe prokurorët, me qëllim të arrestimit të këtyre ri-uzurpuesve dhe të trajtimin e këtyre rasteve seriozisht nga gjykatat në përputhje me Kodin Penal të Kosovës. Shpresohet se arrestimi dhe ndalimi i këtyre kriminelëve do të prodhojë efektin e dëshiruar për të parandaluar rastet e ri-uzurpimeve serike, gjë që sjellë harxhimin e panevojshëm të burimeve të AKP-së dhe të Policisë së Kosovës duke kryer më shumë se një dëbim nga e njëjta pronë, të të njëjtit uzurpues të paligjshëm.

Gjatë vitit 2014, 22 raste për ri-uzurpim janë iniciuar në prokuroritë përkatëse. Asnjë nga këto raste nuk është vendosur nga gjykata themelore përkatëse dhe të gjitha këto raste janë në pritje në prokuroritë apo gjykatat themelore. Kjo sjell numrin e përgjithshëm të rasteve për ri-uzurpim të iniciuar në prokuroritë përkatëse në 355. Nga të cilat 158 raste janë vendosur nga gjykata komunale/themelore përkatëse dhe 197 raste janë në pritje në prokuroritë apo gjykatat themelore.

Pas zbatimit të marrëveshjes së 23 gushtit 2012, në vitin 2013 AKP-ja ka kërkuar arrestimin e 13 personave për uzurpim të paligjshëm. Policia e Kosovës ka arrestuar 1 uzurpues të paligjshëm, 7 uzurpues të paligjshëm nuk ishin të pranishëm në ditën e dëbimit dhe në 5 raste, për shkak të rrethanave të arsyeshme, AKP-ja ka tërhequr kërkesën për arrestim.

5.13 Veprimtaritë informative dhe shpërndarja e informatave për publikun

a.) *Transparenca dhe Informimi*

Gjatë periudhës së raportimit AKP-ja ka ndërmarrë një sërë iniciativash për të qenë më afër palëve në kërkesa, OJQ-ve, organizatave vendore dhe ndërkombëtare dhe publikut të gjerë.

AKP-ja gjithashtu vazhdoi t'i ketë shërbimet e veta si Qendrën e Thirrjeve si dhe linjën telefonike dhe e-mailin (mailbox@kpaonline.org) të dedikuar për informata në mënyrë që palët të mund të informohen shpejt për statusin aktual të kërkesave të tyre, dhe të marrin informacione për procesin dhe procedurat që zhvillohen në AKP.

Agjencia gjithashtu vazhdoi të ketë ueb-faqen (www.kpaonline.org) për kërkesat e AKP-së në mënyrë që të ofrojë një numër të madh të informacioneve dhe statistikave në lidhje me aktivitetet e saj, gjegjësisht për pranimin e kërkesave, vendimmarrjen për kërkesat nga ana e Komisionit, shpërndarjen dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit, menaxhimin e dosjeve të pronave nën administrim dhe skemën e qiradhënies.

Gjatë vitit, AKP-ja ka vazhduar të jetë e pranishme në media. Përfaqësues nga AKP-ja kanë marrë pjesë në intervista në gazeta, radio dhe televizion në lidhje me çështjet pronësore. Gjithashtu AKP-ja rregullisht u ofron mediave informata dhe statistika të përditësuara për aktivitetet dhe politikat e saj, përmes Njësitit të Informimit.

AKP ka caktuar zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare dhe ofron qasje për të gjitha palët e interesuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

b) *Bashkëpunimi në mes Agjencie*

Në përpjekje për t'iu ofruar informacione institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, AKP-ja u takua rregullisht me aktorët tjerë në fushën e të drejtave pronësore me qëllim të ngritjes së vetëdijes për punën e saj dhe rëndësinë e saj në ndërtimin e paqes, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit. Këtu përshihen në mes tjerash edhe UNHCR-ja; OSBE-ja dhe OJQ-të e ndryshme. AKP-ja është takuar gjithashtu me zyrtarë të Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. Përveç kësaj zyrtarët e AKP-së rregullisht kanë marrë pjesë në takime, punëtori dhe seminare brenda dhe jashtë Kosovës, të organizuara nga organizatat dhe OJQ-të e përfshira në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe me procesin e kthimit.

SFIDAT E INSTITUCIONIT/REKOMANDIMET

6.1 Sfidat e vitit paraprak

AKP është institucion i përkohshëm, dhe tashmë është në përfundim të mandatit të vet, ku janë vendosur të gjitha kërkesat e parashtruara në këtë Agjenci, dhe pritet vetëm faza e zbatimit të vendimeve (fazë kjo që parashihet të zgjatë jo më shumë se 18 muaj). Megjithatë edhe gjatë vitit 2014 sfidat e Agjencia kanë qenë mjaft të mëdha. Përfundimi i mandatit të Drejtorit Ekzekutiv (gusht 2014) dhe dorëheqja e zv/Drejtorit Ekzekutiv (korrik 2014), së bashku me shtyrjen e konstituimit të Kuvendit të Kosovës dhe zgjedhjes së Qeverisë së re të Kosovës, ka ndikuar në mos-zëvendësimin e këtyre pozitave. Edhe në momentin e raportimit, Agjencia Kosovare e Pronës udhëhiqet nga Ushtruesja e detyrës së Zëvendësdirjtorit Ekzekutiv, e cila bashkë me stafin tjetër të Sekretarisë Ekzekutive ka arritur që të menaxhojë sfidat me të cilat është ballafaquar AKP.

Sa i përket qëndrueshmërisë financiare, Agjencia Kosovare e Pronës është mbështetur financiarisht nga Buxheti i Kosovës e gjithashtu edhe nga një numër i madh i organizatave dhe partnerëve ndërkombëtarë. Megjithatë, gjatë periudhës raportuese AKP është sfiduar, veçanërisht, nga mos-qëndrueshmëria financiare sidomos në pjesën e donacioneve ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj mos-qëndrueshmërie financiare, një numër i stafit profesional (kryesisht juristë me përvojë shumëvjeçare në fushën e të drejtave pronësore) kanë dhënë dorëheqje dhe janë larguar nga AKP në kërkim të një vendi pune më të qëndrueshëm financiarisht.

Duke qenë se çështja e të drejtave pronësore është e ndjeshme, Agjencia konsideron se Kosova ka nevojë për hartimin e një strategjie kombëtare për të drejtat pronësore, e cila pashmangshëm do të përfshinte një numër të madh institucionesh, organizatash vendore dhe ndërkombëtare. Kjo do të siguronte që të drejtave pronësore do t'u jepej kahje e duhur e organizimit dhe koordinimit, dhe përmirësim të të drejtave pronësore për të gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim etnie.

Procesi i dëbimeve në pjesën Veriore të Mitrovicës më parë ishte penguar dukshëm për shkak të situatës politike dhe tensionit në popullatën lokale. Si rezultat i

kësaj që nga gushti 2011 deri në mars 2014 nuk janë ekzekutuar dëbimet. Nga marsi 2014, dëbimet në veri të Mitrovicës kanë filluar pas negociatave të gjata me Policinë e Kosovës. Që atëherë, janë bërë disa dëbime me ndihmën e Policisë së Kosovës, prandaj AKP ka arritur përparim në fillimin e tejkalimit të kësaj sfide për realizimin e dëbimeve në këtë pjesë të Kosovës.

Miratimi më i shpejtë i Ligjit për themelimin e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave (AKKVP) do t'i hapte rrugë fillimit të mandatit të ri për AKP-në dhe njëkohësisht përmbylljes së procesit të zbatimit të vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) në periudhën e paraparë kohore.

Njëkohësisht AKP-ka ka kërkuar bashkëpunimin e mëtutjeshëm të Policisë së Kosovës dhe të Prokurorisë në mënyrë që të rritet numri i arrestimeve të ri-uzurpuesve serikë dhe numri i lëndëve të dërgohet në gjykata sipas Kodit Penal të Kosovës. Marrëveshja tashmë është arritur në pritje të vendimit me të cilin AKP-ja duhet të drejtohet për të kërkuar që kjo të ndërmerret.

Sa i përket Skemës së Kompensimit, AKP u ka dërguar letër të gjithë donatorëve duke iu ofruar një propozim për financimin e skemës. Çështja i është adresuar edhe Qeverisë së Kosovës për të kërkuar fonde të nevojshme për zbatimin e skemës. Janë mbajtur një sërë takimesh dhe janë planifikuar konsultime të mëtejshme me qëllim të përparimit të çështjes. Janë gjithsej 143 vendime të cilat duhet të zbatohen përmes kompensimit. Shuma e nevojshme për kompensim për këto prona është 3.2 milionë euro. Edhe përkundër përpjekjeve të mëdha, Agjencia nuk ka arritur t'i bind partnerët që t'i ndajnë këto mjete. Pa sigurimin e këtyre mjeteve këto vendime nuk mund të zbatohen dhe të mbyllen lëndët përfundimisht.

6.2 Synimet Operative dhe Treguesit e Performancës

A. Synimet kryesore operative për vitin 2015 në lidhje me vendosjen e kërkesave, dhe njoftimin e palëve për vendimet janë të dhëna më poshtë:

A1. Të ripërpunohen dhe të korrigjohen gabimet e identifikuarra tekstuale dhe të përpunimit në vendimet e KKPK-së deri në muajin qershor 2015;

Treguesi i Performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të vendimeve të identifikuarra të ripërpunuara dhe të korrigjuara të KKPK -së me gabimet tekstuale dhe të përpunimit.

A2. Të ripërpunohen dhe të vendosen të gjitha vendimet e prishura nga Gjykata Supreme deri në fund të dhjetorit 2015;

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të kërkesave të ripërpunuara dhe të vendosura.

A3. Të gjitha kërkesat e vendosura nga KKPK në vitin 2014 përmes lëshimit të vendimeve grupore, do të individualizohen për secilën palë në kërkesë brenda një muaji pas aprovimit të vendimit grupor nga Kryetari i KKPK-së.

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të kërkesave të cilat individualizohen pas miratimit të vendimit grupor, si përqindje e numrit të kërkesave të cilat përfshihen në secilin vendim grupor, siç është detajuar në raportet për KKPK-në dhe Bordin Mbikëqyrës.

A4. Zbatimi i vendimeve të individualizuara duke njoftuar paraqitësit e kërkesave/palës përgjegjëse do të fillojë nga qendra e thirrjeve sapo vendimet e individualizuara të pranohen dhe të përfundohet deri në fund të muajit dhjetor 2015.

Treguesi i performancës

Performanca do të vlerësohet në bazë të numrit të paraqitësve të kërkesave/palëve përgjegjëse të cilët kontaktohen nga qendra e thirrjeve në muajin pas pranimit të vendimeve të individualizuara, si përqindje e numrit të përgjithshëm të pranuar të vendimeve të individualizuara, siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

B. Synimet kryesore operative për vitin 2015 sa i përket zbatimit të vendimeve si dhe synimeve specifike të administrimit të pronës dhe skemës së qiradhënies vullnetare janë të dhëna më poshtë:

B1. Pas pranimit të kërkesës për zbatim nga paraqitësi i suksesshëm i kërkesës, në rastet kur nuk ka pasur ankesë brenda afatit të dhënë, Njësiti i Implementimit do ta përpunojë dhe do t'ia dërgojë kërkesën për zbatim njësitet përkatës brenda një muaji nga data e pranimit të kërkesës. Faza e zbatimit do të përfundojë deri në fund të muajit dhjetor 2015, me mundësi të vazhdimet të paparashikuar deri në qershor 2016.

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të kërkesave që janë përpunuar dhe dërguar në njësitet përkatëse brenda një muaji nga dita e pranimit dhe atyre që kërkojnë më shumë se një muaj kohë për t'i përpunuar siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

B2. Aktivitetet për publikimin e skemës së qirasë për pronën, përfshirja e pronave bujqësore dhe komerciale, në mënyrë që të rritet numri i qiramarrësve në pronat me qira në 1,500 do të ndërmerren në baza të rregullta.

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të ndryshimit në mes të numrit të synuar prej 1,500 prona me qira dhe numrit aktual të pronave të lëshuara me qira, siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

B3. Me pranimin e miratimit të nënshkruar që prona të përfshihet në Skemën e Qiradhënies Vullnetare, Njësiti për Administrimin e Pronës do t'i inspektojë objektet brenda një muaji pas marrjes së miratimit të nënshkruar, në mënyrë që në skemën e qirasë të përfshihen sa më shumë prona të përshtatshme që është e mundur.

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të objekteve të cilat përfshihen në skemën e Qiradhënies Vullnetare brenda një muaji pas pranimit të miratimit të nënshkruar, siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

B4. Pronat nën kujdesin e AKP-së do të vazhdojnë të administrohen në mënyrë efikase gjatë vitit 2015.

Treguesi i Performancës

Performanca do të matet në bazë të inspektimit të rregullt të pronave nën administrim të AKP-së kur

pronat vizitohen çdo gjashtë muaj të përcjellë me fotografi, dhe shënime që shpjegojnë kushtet e pronave si dëshmi për një vlerësim më të mirë të pronave, siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

B5. Do të hiqen nga administrimi objektet e papërfunduara që janë marrë në administrim ex officio.

Treguesi i performancës

Performanca do të matet në bazë të numrit të objekteve të cilat janë kthyer nën përgjegjësinë e autoriteteve përkatëse, siç është detajuar në raportet për Komisionin dhe Bordin Mbikëqyrës.

FINANCIMI DHE BUXHETI

7.1 Financimi

Çështjet buxhetore dhe financiare të AKP-së janë përgjegjësi e Njësitit të Financave të AKP-së. Edhe pse AKP-ja ka mandat për të përmbushur një nga funksionet kryesore të sundimit të ligjit në Kosovë, megjithatë nga institucioni kërkohet të sigurojë pjesën më të madhe të nevojave financiare nga kontributet vullnetare të donatorëve, për ndryshim nga aktivitetet tjera qeveritare të cilat kanë nivelet e duhura të financimit qendror.

Projektligji i Buxhetit për vitin 2014 është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 31 tetor 2013. Ligji i Buxhetit për vitin 2014 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 dhjetor 2013.

AKP-ja gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit 2014 ka adresuar në Ministri të Financave çështjen e diferencës ndërmjet kërkesës buxhetore të AKP-së dhe kufijve buxhetor të propozuar në Qarkoret buxhetore për vitin 2014, me arsyetimin e duhur në mënyrë që të përpiqet dhe të sigurojë fondet e nevojshme për të mbuluar një mungesë në mallra dhe shërbime në shumën prej 207,131€ dhe shpenzime komunale në shumën prej 26,998€ që do të ndodhte në qoftë se do të miratohej projektligji i buxhetit pa ndryshime. Kërkesa për të mbuluar mungesën në mallra e shërbime dhe shërbime komunale është refuzuar, nuk u mbulua.

AKP-ja kishte paraqitur gjithashtu një kërkesë për buxhet shtese për zbatim të vendimeve për skemën e kompensimeve. Kërkesë për buxhet shtese për zbatim të vendimeve nga skema e kompensimeve është refuzuar gjithashtu.

AKP-së në Buxhetin e Kosovës për vitin 2014 i janë ndarë 1.782.000€.

Nëpërmjet procesit të rishikimit gjashtëmuor të buxhetit 2014, AKP-ja ka kërkuar një shumë shtesë prej 265,028€. AKP-ja, ka rishikuar statusin e shpenzimeve dhe nevojat për financim shtesë për pjesën e mbetur të vitit 2014. Kërkesa shtesë prej 265,028€ nevojitet

për të mbuluar pagat bazë prej Buxhetit të Kosovës për stafin, mallra dhe shërbime dhe komunal.

Të hyrat vetanake (THV) të mbledhura gjatë 2014 në vlerë prej 22,316.38€ nuk i janë ndarë AKP-së përmes Ligjit të Buxhetit për vitin 2014.

Gjatë periudhës së raportimit, u pranuan kontributet nga këta donatorë:

Qeveria e Zvicrës është duke mbështetur financiarisht AKP-në me 1,919,000 € për periudhën 2011- 2014 përmes një marrëveshjeje për kontribut të nënshkruar në qershor 2011 në mes të Qeverisë së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave në emër të AKP-së dhe Qeverisë së Zvicrës e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (ZZB). Një shumë fillestare prej 500,000€ është pranuar në korrik 2011, dhe kësti i dytë prej 500,000€ është pranuar në maj 2012 pas miratimit të raportit të projektit dhe raportit të auditorit të jashtëm për vitin 2011. Në muajin nëntor 2012 janë vënë në dispozicion fonde shtesë prej 89,000€ dhe është bërë rishikimi i marrëveshjes së grantit për të adresuar këtë financim shtesë. AKP, në shkurt 2013 nga Qeveria e Zvicrës ka pranuar këstin tjetër prej 180,000€.

Në muajin maj 2013 është bërë amendamenti i dytë i marrëveshjes ekzistuese, të reflektojë kontributin e shtuar të Zvicrës ndaj AKP-së, të adresojë mungesën financiare të AKP-së për vitin 2013 dhe të reflektojë vazhdimin e marrëveshjes edhe gjatë vitit 2014. Është pajtuar që shuma prej 600,000€ të adresohet për vitin 2013.

Bazuar në amendamentin e dytë të marrëveshjes kësti i parë është pranuar në qershor 2013, në shumë prej 300,000€. Kësti i dytë prej 200,000€ është pranuar në gusht 2013 dhe kësti i tretë prej 100,000€ është pranuar në tetor 2013. Transferi i fundit prej 50,000 € është pranuar nga AKP-ja në tetor 2014.

²Skemën e kompensimeve, për zbatimin e vendimeve të nxjerra në bazë të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 i cili rregullon rastet e veçanta të kthimit të së drejtës së banimit në banesat shoqërore të humbura si pasojë e diskriminimit.

Përveç kësaj, Qeveria Zvicerane ka financuar edhe një projekt me titull “Mbështetje për AKP-në”, i cili ishte projektuar për këshillim të mëtejshëm strategjik dhe udhëzime për Bordin Mbikëqyrës dhe Sekretarinë Ekzekutive, në lidhje me fazat e vendosjes dhe zbatimit të mandatit të AKP-së dhe të ardhmen e saj pasi të kenë përfunduar këto aspekte të mandatit të saj. Projekti i fundit ka përfunduar në shtator 2014 me publikimin e një raporti të vlerësimit për periudhën 2006-2014

Qeveria e Norvegjisë ka mbështetur AKP-në me një grant në shumën prej 1,4500,000NOK që (152,840.73€), për periudhën deri në shkurt 2015. Kësti prej 152,840.73€ është pranuar në dhjetor 2014.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara ka vazhduar të mbështes AKP-në, përmes marrëveshjes së kontributit të nënshkruar në shkurt 2014, në shumën prej 500,000 USD (përafërsisht. 360,550 €). Nga kjo shumë AKP-ja ka pranuar në mars këstin e parë në shumë prej 288.122 USD që është ekuivalent me 207,955€. Kësti i dytë prej USD 211,878 që është ekuivalent me 152.595€ është pranuar në prill 2014.

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ka mbështetur financiarisht AKP-në me një shumë prej 89,095£ ekuivalente me 106,023€ për tremujorin e parë të vitit 2014. Transferi i 4,655£, që është ekuivalent me 5,632€ që përfaqëson këstin e fundit të marrëveshjes së grantit për periudhën 2013-2014 të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar është pranuar në mars 2014.

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes marrëveshjes së kontributit të nënshkruar në maj 2014 ka rënë dakord të mbështet AKP-në me 428,597£ që është ekuivalent me 533,133€ për periudhën deri në dhjetor 2014.

Kësti i parë prej 232.683£ që është ekuivalent me 285.665€ është pranuar në qershor 2014. Kësti i dytë prej 182,040£ që është ekuivalent me 230,008 € është pranuar në gusht 2014 dhe kësti i tretë prej 13.874 £ që është ekuivalent me 17.460 € është pranuar në tetor 2014.

7.2 Zbatimi i Buxhetit

Bashkëngjitur si Shtojca C e raportit është Buxheti i AKP-së për vitin 2014 i cili është ndarë si në vijim:

Paga dhe Mëditje:	1,298,413
Mallra dhe Shërbime*:	885,892
Shërbime Komunale:	96,510
Investime Kapitale:	94,000
Gjithsej:	2,374,815

(*pagat e gjithë stafit vendorë jashtë Kosovës paguhen nga kjo kategori ekonomike)

Duke pasur parasysh nevojat e rishikuara të AKP-së dhe marrjen e fondeve shtesë të donatorëve gjatë periudhës së raportimit, bashkëngjitur si Shtojca D gjenet buxheti i rishikuar i AKP-së për vitin 2014 KPA me alokimet e rishikuara:

Paga dhe Mëditje:	1,946,549
Mallra dhe Shërbime*:	872,931
Shërbime Komunale:	100,523
Investime Kapitale:	70,510
Gjithsej:	2,990,513

(*pagat e gjithë stafit vendorë jashtë Kosovës paguhen nga kjo kategori ekonomike)

Bashkëngjitur si Shtojca E është pasqyra e Buxhetit të AKP-së për vitin 2014 e cila pasqyron mënyrën se si është shpenzuar Buxheti. Si përmbledhje, shuma e përgjithshme e përvetësuar nga BKK për vitin 2014 ishte 1,748,856.64 prej së cilës janë shpenzuar 1,690,324.57€. Shuma e mbetur prej 58,532.07€ e cila nuk ka mundur të shpenzohet brenda vitit 2014 është për shkak të diferencës ndërmjet shumës së planifikuar kundrejt shumës aktuale të shpenzuar.

Shuma e donacioneve ishte 1,241,655.94€ prej së cilës janë shpenzuar 1,241,655.94€. Një shumë prej 84,002.28€, si pjesë e fondeve të donatorëve të pranuar në dhjetor 2014, ishte planifikuar të bartej në vitin 2015 dhe si e tillë nuk është e përfshirë në totalin e mësipërme.

Përqindja e shpenzimeve nga mjetet e ndara nga buxheti i BKK-së për buxhetin e AKP-së për vitin 2014 ishte 96.65%. Sa i përket fondeve të donatorëve përqindja e shpenzimeve ishte 93.66%.

7.3 Vlerësimi i donatorëve

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB) në Kosovë ka autorizuar vlerësimin e AKP-së nga konsulentë të jashtëm, i cili është paraqitur në raportin “Vlerësimi përfundimtar i Agjencisë Kosovare të Pronës (APK)

nga 2006 deri më 2014”, i parashtruar më 3 shtator 2014. Të gjeturat në raport janë nxjerrë nga vrojtimet dhe të dhënat e mbledhura gjatë disa misionëve që përfshijnë vlerësimin 6 mujor më 2010 dhe katër misione (2011-2013) që kanë të bëjnë me mbështetjen e mandatit të AKP-së të autorizuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB). Duke ditur edhe mbështetjen afatgjate financiare të Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (ZZB) dhënë DÇPB-së dhe AKP-së, raporti mund të konsiderohet si vlerësimi përfundimtar për rëndësinë institucionale, efikasitetin dhe efektshmërinë e AKP-së.

Raporti fillimisht paraqet që...“sa i përket efikasitetit, AKP-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë institucion i rëndësishëm në Kosovë. Paraqitësit e kërkesave në përgjithësi janë mirënjohës për shërbimet dhe ekzistimin e AKP-së. Duke pasur parasysh mandatin e AKP-së si instrument ligjor për kthimin në masë të pronave, mund të arrihet në përfundim që gjer më sot nuk ka pasur alternativa të mundshme përveç AKP/ KKPK për të kthyer të drejtat pronësore në mënyrë masive. Gjithashtu, gjatë punës së saj AKP-ja ka krijuar reputacion solid profesional. Është konsideruar transparente, bashkëpunuese dhe përgjegjëse për të ngritur nevojat e paraqitësve të kërkesave dhe ato institucionale”.

Konsulentët vërejnë se...“që nga fillimi i saj më 2006, AKP-ja dhe donatorët e saj mbështetës kanë demonstruar aftësinë për t’u adaptuar në një varg rrethanash kontekstuale e sfiduese. Kthimi i të drejtave pronësore në Kosovën e pas konfliktit ishte kritik për zgjidhjen e kthimit të pronave banesore, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe përforsimin e pajtimit. Në këtë kuptim, e themeluar si një instrument i përkohshëm i drejtësisë, AKP-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit në Kosovë pas vitit 1998-99.

Mbështetja afatgjate e Zvicrës për AKP-në ishte e dobishme në vazhdimin e përkrahjes këtij procesi. Se si AKP-ja të jetë e efektshme si institucion tërësisht i Kosovës, megjithatë, kjo mbetet të zgjidhet. Nuk duhet të neglizhohet që stabilizimi i qeverisjes së të drejtave pronësore në Kosovë do të mbetet problem primar në vitet në vijim. Sigurimi i stabilitetit të të drejtave pronësore do të jetë kritike për të mbështetur përkujdesjen socio-ekonomike të pronarëve dhe për ofrimin e mbrojtjes adekuate ligjore për funksionimin e duhur të tregut të patundshmërive, e gjithashtu edhe për krijimin e ambientit për investime në Kosovë”.

Në vërejtjet përfundimtare të raportit thuhet që...“Zvicra ka demonstruar konsistencë strategjike duke e mbështetur DÇPB-në që nga viti 2000 dhe duke vazhduar përkrahjen financiare të AKP-së, e gjithashtu edhe me mbështetjen profesionale gjatë kohëve të vështira gjer në përfundimin e procesit të vendimmarrjes më 2014. Është krijuar mjedisi institucional për përfundimin e mandatit të AKP-së. Tani mbetet që institucionet Kosovare (Qeveria/ Parlamenti) të ofrojnë një mjedis në të cilin mandati mund të finalizohet tërësisht dhe të bëhet i qëndrueshëm”.

ADRESIMI I KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2014 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të AKP-së për vitin 2013. Sipas opinionit të ZAP-it, *pasqyrat financiare të AKP-së për vitin 2013 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (Opinion i Pamodifikuar)*.

Për fushat siç janë: rekomandimet e vitit paraprak, të hyrat, shpenzimet jo përmes prokurimit, subvencionet dhe transferet, pasuritë dhe detyrimet, trajtimi i borxheve dhe sistemi i auditimit të brendshëm, ZAP nuk ka çështje të ngritura dhe nuk ka rekomandime.

Më gjithë progresin e arritur nga AKP-ja në dizajnimin e një sistemi të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, ZAP ka vërejtur disa fusha në të cilat nevojiten kontrole shtesë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka rekomanduar menaxhmentin e AKP-së se nevojitet kontroll shtesë, dhe: Drejtori Ekzekutiv duhet të sigurojë se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje, të sigurojë se të gjitha shpenzimet janë regjistruar në


kategoritë ekonomike adekuate; Drejtori Ekzekutiv duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe me rregulla të thesarit; Drejtori Ekzekutiv në bashkëpunim me donatorët t'i rishqyrtojnë vendimet e marra dhe të rishikojë mundësitë që donacionet e dhëna për paga dhe mëditje si dhe sigurime shëndetësore të mbulojnë gjithë stafin e AKP-së. Gjithashtu, të sigurojë se pagesat e sigurimeve shëndetësore kanë bazë të qëndrueshme ligjore.

AKP ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve, dhe deri në fund të vitit 2014 ka adresuar një pjesë të rekomandimeve dhe një pjesë është në proces të adresimit.

³Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor të Auditimit. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200).

SHTOJCAT

Shtojca A - Struktura organizative e AKP-së



Shtojca B - Statistikat rreth vendosjes së kërkesave deri në dhjetor 2014

STATISTIKAT KRYESORE RRETH VENDOSJES SË KËRKESAVE DHE RIVENDOSJES SË KËRKESAVE DERI NË DHJETOR 2014

Gjithsej të vendosura			42,055		
Gjithsej të shfuqizuara			18,738		
Gjithsej të vendosura më pak vendime të shfuqizuar			23,523		
Plus vendime të rivendosura			18,532		
		Gjithsej	41,849		

STATISTIKAT RRETH VENDOSJES SË KËRKESAVE DERI MË 31 DHJETOR 2014

2007-2014	Seanca e KKPK	Nr. i kërkesave të referuara Komisionit	Kërkesa të vendosura	Kërkesa të kthyera Sekretarisë	
				Numrat	% të referuara
qershor-07	Seanca 1	955	498	457	48
gusht-07	Seanca 2	1179	487	692	59
tetor-07	Seanca 3	544	528	16	2.9
dhjetor-07	Seanca 4	1863	1833	30	1.6
shkurt-08	Seanca 5	2415	2403	12	0.5
prill-08	Seanca 6	2617	2586	31	1.18
qershor-08	Seanca 7	2880	2850	30	0.87
gusht-08	Seanca 8	3050	2920	130	4.26
tetor-08	Seanca 9	2622	2594	28	1.07
dhjetor-08	Seanca 10	2190	2140	50	2.34
prill-09	Seanca 11	512	504	8	1.5
qershor-09	Seanca 12	2520	2474	46	1
gusht-09	Seanca 13	1094	859	235	21.4
dhjetor-09	Seanca 14	619	583	36	0.58
shkurt-10	Seanca 15	1183	1094	89	0.92
prill-10	Seanca 16	528	521	7	0.98
qershor-10	Seanca 17	611	597	14	0.97
gusht-10	Seanca 18	1007	974	33	0.98
tetor-10	Seanca 19	339	324	15	4.6
dhjetor-10	Seanca 20	174	171	3	1.75
shkurt-11	Seanca 21	697	665	32	4.8
maj-11	Seanca 22	406	404	2	0.5
qershor-11	Seanca 23	645	636	9	1.4
shtator-11	Seanca 24	911	875	36	4.1
tetor-11	Seanca 25	820	816	4	0.4
dhjetor-11	Seanca 26	632	619	13	1.9
shkurt-12	Seanca 27	1005	925	55	0.6
prill-12	Seanca 28	849	600	2	0.04
qershor-12	Seanca 29	845	1022	13	0.01
shtator-12	Seanca 30	1189	1161	20	0.01
tetor-12	Seanca 31	735	734	8	0.01

dhjetor-12	Seanca 32	625	615	4	0.003
shkurt-13	Seanca 33	693	692	4	0.005
prill-13	Seanca 34	661	660	1	0.001
qershor-13	Seanca 35	492	492	1	0.002
gusht-13	Seanca 36	811	794	17	0.02
nëntor-13	Seanca 37	1058	1044	15	0.01
mars-14	Seanca 38	929	924	5	0.005
prill-14	Seanca 39	503	501	4	0.01
qershor-14	Seanca 40	305	295	10	0.01
gusht-14	Seanca 41	296	287	9	0.02
tetor-14	Seanca 42	193	183	10	0.1
Dhjetor-14	Seanca 43	155	171		
Gjithsej të vendosura		44,405	42,077	2,236	
Të shfuqizuara			18,559		
Gjithsej			23,518		

Shtojca C Buxheti i AKP-së për 2014

AKP - Buxheti i Donatorëve për 2014	Shpenzimet vjetore	të alokuara	nevojat shtesë
Totali:	1,493,808	592,815	900,993
Paga dhe Mëditje	1,021,459	341,951	679,509
pagat e stafit lokal	1,021,459	341,951	679,509
Mallra dhe Shërbime	204,834	100,053	104,780
Pagat e stafit jashtë Kosovës	110,316	47,035	63,281
Sigurimi shëndetësorë	52,147	26,774	25,373
Qiraja	13,484	6,742	6,742
Paratë e imëta	18,000	12,970	5,030
Tjera	8,410	4,055	4,355
Auditimi i jashtëm/ndryshimet në kurset e këmbimit	2,477	2,477	0
Transferi për UNDP-në	84,940	61,105	23,835
UNV-të	182,575	89,706	92,869

shënime:

UNV-të - Janar- Dhjetor 2014 kostoja totale prej 248,294\$ e barasvlershme me 182,575 €.

Mallrat dhe shërbimet tjera përfshijnë- transferet për UNHCR (2,400€ për qiranë në Kragujevc dhe 6,010€ për shpenzime tjera)

UNDP - 114,410 \$/84,940.47€

AKP - Buxheti i Kosovës 2014	Shpenzimet vjetore	të alokuara	nevojat shtesë
total:	2,082,223	1,782,000	300,223
Paga dhe Mëditje	1,022,556	956,462	66,094
Mallra dhe Shërbime	842,159	635,028	207,131
Shërbime Komunale	123,508	96,510	26,998
Investime Kapitale	94,000	94,000	0

AKP - Buxheti total 2014	Shpenzimet vjetore	të alokuara	nevojat shtesë
Totali i Donatorëve dhe BKK-së	3,576,031	2,374,815	1,201,217

Shtojca D Buxheti i rishikuar i AKP-së për 2014

AKP - Buxheti i Donatorëve për 2014	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
Totali:	124,278	1,493,808	1,241,655.94	1,241,656	0
Paga dhe Mëditje	85,122	1,021,459	913,500	913,500	0
Pagat për stafin vendor	85,122	1,021,459	913,500	913,500	0
Mallra dhe Shërbime	16,863	204,834	151,190	151,190	0
Pagat e stafit jashtë Kosovës	9,193	110,316	79,309	79,309	0
Sigurimi shëndetësor	4,346	52,147	47,631	47,631	0
Qiraja	1,124	13,484	9,982	9,982	0
Paratë e imëta	1,500	18,000	7,836	7,836	0
Tjera	701	8,410	6,432	6,432	0
Auditimi i jashtëm/ndryshimet në kurset e këmbimit		2,477	0	0	
Transferi për UNDP-në	7,078	84,940	44,405	44,405	0
UNV-të	15,215	182,575	132,562	132,562	0

Shënime:

UNV-të - Janar- Dhjetor 2014 kostoja totale prej 248,294\$ e barasvlershme me 182,575 €.

Shpenzimet tjera m&sh - transferet për UNHCR (2,400 për qiratë në Kragujevc dhe 6,010 për shpenzime tjera)

UNDP - 114,410 \$/84,940.47€

Shuma prej € 84,002.28 është pjesë e fondeve të donatorëve të pranuar për periudhën Dhjetor 2014 të cilat janë planifikuar që të barten në 2015 prandaj nuk janë futur në këtë tabelë.

AKP - Buxheti i Kosovës 2014	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
total:		2,088,279	1,748,857	1,748,857	0
Paga dhe Mëditje		1,022,556	1,033,049	1,033,049	0
Mallra dhe Shërbime		848,214	544,774	544,774	0
Shërbime Komunale		123,508	100,523	100,523	0
Investime Kapitale		94,000	70,510	70,510	0

AKP - Buxheti total 2014	kosto mujore	kosto vjetore	Buxheti i reviduar	të zotuar	nevojat shtesë
	a	b=a*12	c	d	e=c-d
Totali i Donatorëve dhe BKK-së		3,582,087	2,990,513	2,990,513	0

Shtojca E pasqyra e shpenzimeve të Buxhetit të AKP-së për vitin 2014

Kodi Ekonomik	BKK	A	B	C	D=B-C	C/B
		Buxheti	Alokimi	Shpenzimet	Të pashpenzuara	Shpenzuar kundër buxhetuar (%)
	AKP Total	1,748,856.64	1,748,856.64	1,690,324.57	58,532.07	96.65%
11100	Pagat dhe Mëditjet	1,033,049.34	1,033,049.34	1,032,610.59	438.75	99.96%
13000	Mallrat dhe Shërbimet	544,774.30	544,774.30	513,208.90	31,565.40	94.21%
13200	Shpenzimet Komunale	100,523.00	100,523.00	99,627.51	895.49	99.11%
30000	Shpenzimet Kapitale	70,510.00	70,510.00	44,877.57	25,632.43	63.65%
Kodi Ekonomik	Donatorët	A	B	C	D=B-C	C/B
		Buxheti	Alokimi	Shpenzimet	Të pashpenzuara	Shpenzuar kundër buxhetuar (%)
	AKP Total	1,325,658.22	1,325,658.22	1,241,655.94	84,002.28	93.66%
11100	Pagat dhe Mëditjet	997,501.91	997,501.91	913,499.63	84,002.28	91.58%
13000	Mallrat dhe Shërbimet	328,156.31	328,156.31	328,156.31	0.00	100.00%
13200	Shpenzimet Komunale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%
30000	Shpenzimet Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00%

Shtojca F - Pronat nën administrimin e AKP-së sipas rajoneve dhe komunave

Komuna	Të iniciuara nga HPD (ex officio)	Paraqitësi i Kërkesës HPCC:	Kërkesës e Paraqitësit të Kërkesës i KKPK-së
Gjithsej	329	2048	9761
MITROVICË	56	637	1491
Leposaviq	0	0	5
Mitrovicë	41	540	219
Skënderaj	0	23	620
Vushtrri	15	48	586
Zubin Potok	0	10	60
Zveçan	0	16	1
GJILAN	64	158	2121
Gjilan	26	20	314
Kamenicë	29	2	206
Kaçanik	0	14	66
Novobërdë	0	7	335
Shtërpçë	1	1	22
Ferizaj	1	81	661
Viti	7	33	527
PEJË	106	814	3866
Gjakovë	13	242	172
Deçan	10	241	151
Klinë	7	27	981
Istog	16	97	1889
Pejë	60	207	673
PRISHTINË	82	242	1133
Glllogoc	0	1	0
F.Kosovë	5	20	21
Lipjan	10	15	256
Obiliq	20	65	82
Podujevë	0	21	470
Prishtinë	44	112	255
Shtime	3	8	49
PRIZREN	21	197	1150
Dragash	0	4	0
Malishevë	0	0	268
Rahovec	0	25	100
Prizren	20	115	477
Suharekë	1	53	305

NGJARJET KRYESORE GJATË VITIT 2014

Janar - Qeveria Britanike i siguroi AKP-së fonde shtesë në shumën prej 89,095£ që është ekuivalent me 106,023€.

AKP-së i është aprovuar shuma prej 1,782,000€ nëpërmjet Ligjit për Buxhetin e Kosovës, për vitin 2014.

MiM është nënshkruar mes Policisë së Kosovës dhe AKP-së duke siguruar ndihmën e policisë gjatë dëbimeve.

Zyra e UNHCR-it për Pronën në Nish, Serbi, është mbyllur për shkak të mungesës së fondeve.

Mars - Qeveria Britanike i siguroi AKP-së fonde shtesë në shumën prej 4,655 £ ekuivalent me 5,632€. Transferi prej 4655£ që është ekuivalent me 5,632€ paraqesin koston e fundit të marrëveshjes për grantin për periudhën 2013-2014 të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara i ka ndarë AKP-së një grant në shumën prej 500,000 USD (përafërsisht. 360,550 €) përmes Marrëveshjes për grant që është nënshkruar në shkurt 2014. Kësti i parë në shumë prej 288,122 USD që është ekuivalent me 207,955€ është pranuar në muajin Mars. Në muajin prill u pranua shuma prej 211,878 USD që është ekuivalent me 152,595€ që përfaqëson koston e dytë të kontributit të Shteteve të Bashkuara.

AKP ka mbajtur trajnim të kandidatëve për gjykatës dhe prokuror në lidhje me mandatin dhe funksionimin e Agjencisë, e gjithashtu edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me zgjidhjen e kontesteve pronësore në Kosovë.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të 38të duke vendosur 929 kërkesa.

Është lëshuar raport i vjetor i AKP-së për vitin 2013.

Prill – Më 11 prill, Kuvendi i Kosovës riemëron z.Adem Vokshi si anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës me mandat 1 vjeçar.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të 39të duke vendosur 503 kërkesa.

Maj - u nënshkrua marrëveshja e kontributit në mes Qeverisë Britanike dhe Qeverisë së Kosovës për mbështetje financiare për AKP-në për periudhën deri në gusht 2014 në shumë prej 428,597£ që është ekuivalent me 533,133€, është nënshkruar për periudhën deri në gusht 2014.

Zyra e AKP-së në Graçanicë është mbyllur për shkak të mungesës së fondeve.

Qershor - Zyra e AKP-së në Podgoricë, Mal i Zi, është mbyllur për shkak të mungesës së fondeve.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të 40të duke vendosur 305 kërkesa.

Korrik - Qeveria Britanike ka liruar koston e parë të marrëveshjes së kontributit 2014 në shumën prej 232,683£ që është ekuivalent me 285,665€.

Qeveria Zvicerane ka liruar koston përfundimtar të marrëveshjes së kontributit 2011-2014 në shumën prej 50,000€.

Më 05 Korrik 2014 Zëvendësudrejtori Ekzekutiv, z. Xhevat Azemi jep dorëheqje.

Më 29 korrik 2014 znj. Florije Kika emërohet nga Bordi Ekzekutiv ushtrues detyre e Zëvendësudrejtorit Ekzekutiv.

Qeveria Norvegjeze, përmes NORDEM, ka dërguar kontraktues si Udhëheqës i Departamentit Ligjor të AKP-së, gjithashtu, ua ka vazhduar kontratat 2 zyrtarëve ligjor ndërkombëtar.

Gusht - Qeveria Britanike ka liruar koston e parë të marrëveshjes së kontributit 2014 në shumën prej 182,040£ që është ekuivalent me 230,008€.

Më 27 gusht, z. Veijo Heiskanen dhe z. Norbert Wühler riemërohen edhe për një mandat si anëtarë të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK).

Po ashtu, në të njëjtën datë z. Ian Cliff, znj. Christine Jaenicke dhe Tod Christiansen janë emëruar si anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të AKP-së.

Më 31 gusht, Drejtori Ekzekutiv i AKP-së, z. Marian Nieora përfundon mandatin e tij në krye të AKP-së.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të 41të duke vendosur 296 kërkesa.

Shtator – ZZB dhe Qeveria Gjermane është pajtuar për kontraktimin e dy zyrtarëve ligjor ndërkombëtar, respektivisht nga një në secilin njësiti për përpunimin e kërkesave në AKP.

Tetor - Qeveria Britanike ka liruar këstin e parë të marrëveshjes së kontributit 2014 në shumën prej 13,874£ që është ekuivalent me 17,460€.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të 42të duke vendosur 193 kërkesa.

Nëntor –Më 15 nëntor iu ka skaduar mandati dy anëtarëve vendorë të Bordit Mbikëqyrës, z.Ujup Krasniqi dhe Ismajl Osdautaj.

Dhjetor - U nënshkrua marrëveshja e kontributit në mes Qeverisë Norvegjeze dhe AKP-së për mbështetje financiare për AKP-në për periudhën deri në shkurt 2015 në shumën prej 1,450,000 NOK që është ekuivalent me 152,840.73€. Kësti në shumën prej 152,840.73€ është pranuar në muajin dhjetor 2014.

Më 23 dhjetor 2014, AKP ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Joqeveritare “Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë” (SHPRK) për bashkëpunim të ndërsjellë.

KKPK ka mbajtur seancën e saj të fundit të 43të duke vendosur 155 kërkesat e fundit të paraqitura në AKP, me këtë, duke përfunduar fazën e vendimmarrjes të AKP-së.



ZYRAT E KPA-a.

Selia

Perandori Justinian 5, Prishtinë,
tel. 038 249 918, fax. 038 249 919.

Gjilan

Medlin Ollbrajt 199,
tel. 0280 320 289, fax. 0280 324 067.

Mitrovicë

Shemsi Ahmeti, pn-,
tel. 028 530 136/7,
Pjesa Veriore e Mitrovicës;
Filip Visnjic (ndërtesa e Trepçës) kati 2 nr.18. 065 577-8-550

Pejë;

Mbretëresha Teutë 85,
tel. 039 431 668, fax. 039 432 970.

Prishtinë;

Rexhep Luci 2,
tel. 038 225 473, fax. 038 244 854.

Prizren,

Jeronim De Rada nr.74,
tel. 029 231 469, fax. 029 231 429.

Zyrat e UNHCR-it për çështje pronësore

UNHCR-i ka dy zyre për çështje pronësore në mënyrë që të ndihmojë të gjithë personat që kanë paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të pronës, e të cilat mund t'i kontaktoni në adresat e mëposhtme.

Beograd;

Višegradska 23,
tel.011 362 13 93/94, fax.011 361 27 48.

Kragujevc;

Kralj Aleksandra I Karadjordjevica 102, zyrja 26, Shopping Mall
tel.034 376 455